

1. Vëzhgime paraprake

Kolegji Ilirik i Loretos është njëri ndër ato institucione jetëgjata të formimit klerikal-intelektual, ku u përgatitën breza të tërë barinjsh shpirtërorë me destinacion edhe Provincën Kishtare të Arbënit¹ dhe Arqipeshkëvinë e Shkupit, duke nxitur kështu në mënyrë sado të tërthortë si lëvrimin e kulturës së shkrimit shqip, ashtu edhe vetë debatin intelektual-albanologjik përgjatë shek. XVII-XIX në Arealin Kulturor të Veriut. Mjafton të përmendin këtu tri *B-të* e famshme në historinë e kulturës shqiptare në shek. XVII: Pjetër Budin, Frang Bardhin dhe Pjetër Bogdanin, për të vijuar një shekull më pas me bartës shkronjash të tjera alfabeti, si p.sh.: Gjon Pagëzues Nikollë Kazazin, madje deri në gjysmën e dytë të shek. XIX, ku feksin emrat e Engjëll Radojës, Ndre Logorecit etj. Kësaj aradhe klerikësh intelektualë shqiptarë lejohemi t'i shtojmë sipas kohës dhe rastit edhe syresh të tjerë, ish-rishtarë të këtij kolegji, të cilët në fakt i njohim thjesht dhe vetëm me emra si të tillë dhe ëndërrojmë gjithherë të kemi fatin me shfletuar dikur prurjet e tyre të ngahershme teologjike-shkencore, të cilat jemi të detyruar ndërkohë t'i klasifikojmë thjesht dhe vetëm si trashëgimi e humbur ase e bjerrë njëherë e përgjithmonë, të tilla si: ajo “gramatikë fort e godiçime latin e shqip” me autor Andrea Bogdanin e që “ntreti si krypa nd’ujët”,² apo një punim i përfunduar në dorëshkrim i Gjon P. Nikollë Kazazit, sikurse teksti shqip i një doktrine të krishterë të nxënësit të tij Pal Zogaj që u dogjën dikur me dhe pa dashje si kashta në zheg, etj.³

1 Lidhur me Provincën Kishtare të Arbënit si njësi e dallueshme administrative në hartën ekleziastike të Vatikanit në shek. e 18-të me arqipeshkëvitë dhe dioqezat përkatëse, shih hollësisht DEMIRAJ 2012 9vv., ndërsa për kufijtë gjeografikë të të ashtuquajturit Dheu i Arbënit në shek. e 17-të e të 18-të shih së fundi DEMIRAJ 2008 490-491 (= BLANCHUS 1635 197)

2 Shih BOGDANI 1685: *Të primitë* [f. XV] (tejshkrim i OMARI-t 2005 *loc. cit.*)

3 Sa i përket djegies së papërgjegjshme të të gjitha materialeve shkrimore që la trashëgim Kazazi, mësojmë prej një burimi arkivor (SC SC Servia I 588: letër e Mati Mazrekut <Matteo Masarek> më 12.06.1760), se si: <[...] dopo la morte del degnissimo Arciv. Mons. Nicolovich [= Kazazi – B. D.] mio antecessore, il di lui Fra[te]llo, per averli ordinato il detto Arciv[escovo] di abbruciare alcuni suoi secreti manoscritti, esso ignorantem[en]te assieme con un ignorante sacerdote non Alunno, hanno bruciato due piene casse di tutte quante Scritture, Relazioni di visite, un tomo di compositioni famosissime, che pensava di stampare, privilegi Bolle e tutti l'ordini de sommi Pontefici [...]> (më hollësisht DEMIRAJ 2013 103). Lidhur me djegien e pafat të një katekizmi

Asgjëmangut i mëshojmë që në fillim, madje qysh në paragrafin e parë të këtyre vëzhgimeve hyrëse, kësaj pamjeje qoftë edhe anësore të veprimtarisë së Çetës së Barinjve të këtyre trevave, të cilët përthithën me ngazëllim dikur në të ri të vet bashkë me Thirrjen Hyjnore edhe atë program solid teologjik-mësimor të Kolegjit Ilirik të Loretos (*Ratio studiorum*), duke veshur së fundi pa drojë e pa tutë veladonin e misionarit apostolik në një mjedis social-ekonomik dhe kulturor-historik pak ose aspak të pëlleshëm, sa i përket angazhimit të tyre social e intelektual; bash ato mote, kur e gjithë hapësira kompakte shqipfolëse në perëndim dhe qendër të Gadishullit Ballkanik ishte kthyer me kohë dhe ndërkohë në një zonë sado periferike të Perandorisë Osmane. Kësaj dore barinjsh shpirtërorë lejohemi tash t'i shtojmë shumë e shumë emra të tjerë; e për këtë mjafton të mbajmë vath në vesh e assesi kripë në sy numrin e gjithë atyre ish-rishtarëve të këtij koleji, që vinin atëbotë prej këtij areali etnik-kulturor e që mundën të ngjiteshin deri në katedrën e ipeshkvit ase të arqipeshkvit në njërin apo tjetrën dioqezë e arqipeshkëvi të tij. Sigurisht që ky numër shkon në këtë rast diku te shifra 20, ndërkohë që – siç rezultojnë llogaritjet paraprake – thuajse gjashtëfishi i këtij numri rishtarësh u ulën dikur në bankat dhe aulat mësimore të këtij koleji.

Janë bash këta emra e këto shifra që sendërtojnë së bashku në një formë a një tjetër atë shtresë sado modeste të elitës intelektuale që përkujdeste bindshëm dhe vetëdijshtëm të paktën dy ndër komponentët themelorë të matriksit të kulturës etnike të popullit shqiptar përgjatë shekujve XVI-XIX: besimin shpirtëror dhe trashëgiminë kulturore diturake (edhe) në gjuhën shqipe. Bëjmë fjalë këtu pikërisht për atë elitë të botës intelektuale shqiptare, e cila jo për mëshirë të fatit, por thjesht dhe vetëm për turp të procesit të dikurshëm galvanizues: *damnatio memoriae* në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shek. XX, rrezikon sot të rrëgjohet njëherë e përgjithmonë nga kujtesa historike-intelektuale shqiptare.⁴

* *

*

Mbyllim këtu këto vëzhgime paraprake, duke shprehur njëherazi dëshirën farëmirë për t'i mundësuar një ditë si këtij koleji ashtu edhe shumë e shumë rishtarëve shqiptarë që studioan në të, bash atë vend të

shqip në Vjenë, në shtypshkronjën e Derës së Habsburgut kumton së fundi AHMETI 2003 91.

- 4 Kjo dukuri është vënë disa herë në dukje prej autorit të këtij shkrimi (DEMIRAJ 2016v.), por hetohet në detaj në një studim të fundit mbi tranzicionin intelektual në shoqërinë e sotme shqiptare (DEMIRAJ 2016), ku fokusohet në bashkëlidhje me një dukuri të dytë, atë të *laudatio funebris* si “fjalë mortore” e 124 (prej gjithë-gjithë 168) anëtarëve të bordit redaksional të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (bl. I-III, Tiranë 2008-2009), të cilët i kanë mundësuar vetes një zë enciklopedik – kryesisht të tipit të mesëm – në këtë fjalor.

munguar që i takonte dikur dhe i takon gjithherë në botimet akademike me karakter njohës-enciklopedik në kulturën shqiptare. E theksojmë këtë detaj, duke i mëshuar fort që në fillim karakterit kryesisht njohës dhe enciklopedik të vetë punimit tonë si pjesë e një projekti afatgjatë lidhur me hetimin e vatrave të formimit intelektual-fetar, përkatësisht me njohjen e nivelit të debatit kulturor-albanologjik në hapësirën kompakte shqipfolëse gjatë shek. XVI-XIX.⁵

Sa i përket kolegjit në fjalë, do të mjaftohemi së pari me një përshkrim sado të thukët të rrethanave kulturore e politike-fetare që nxitën dhe mundësuan hapjen e tij në Loreto (1580), duke vijuar më pas me shkaqet dhe pasojat që shoqëruan zhvendosjen drejt Romës (1593-1624) dhe kthimin e tij rishtas në Loreto (1624-), sikurse me mbylljen (-1798) dhe rihapjen (1834-), përkatësisht rimbylljen e tij “përfundimtare” (1860), që vjen me thënë ndryshimin e destinacionit zanafillës në programin e vet mësimor (1860-). Kemi të bëjmë pra me odisenë e një gjallese thuajse treshekullore të këtij institucioni të edukimit fetar-intelektual. Rubrika të veçanta në punim mëton përshkrimi i programit mësimor dhe i jetës së përditshme në kolegji. Në përputhje me këtë synim kryesor tonin parapëlqejmë të ilustrojmë rastet që marrim në shqyrtim kryesisht me detaje të regjistruara për ata rishtarë që vinin në kolegji nga dy njësitë administrative kishtare me shumësi shqipfolëse që përmendëm më lart. Në funksion të po këtij qëllimi kemi përfshirë gjithashtu në fund si pjesë e dytë e punimit edhe një listë pak a shumë të plotë me të dhënat biografike kryesore për të gjithë ata rishtarë që erdhën e mësuan në kolegji nga ato treva.

Së fundi edhe dy fjalë lidhur me letërsinë shkencore dhe fondet arkivore që kemi mundur të shfrytëzojmë gjatë realizimit të këtij studimi: Shumëkush që do dhe kërkon të marrë informacion paraprak, por të dorës së parë, mbi Kolegjin Ilirik të Loretos, vështirë se do të mund t’i anashkalojë tezës së doktoratës së murgut jezuit Josip Jurić (1932: dorëshkrim latinisht – 180 f.⁶), e cila ka parë pjesërisht dritën e botimit në kroatisht (Jurić 1982), së bashku me një listë me 350 emra rishtarësh, që vizituan atë kolegji në vitet 1580 – 1686 (Jurić & Korade 1983).⁷ Vëzhgime plotësuese ndeshim së fundi edhe në një punim sintezë të Slavko Kovačić-it (2003 219vv.), si edhe në ndërhyrjen e thukët të Floriano Grimaldi-t (2006 [I] 351vv.), i cili

5 Për jetën e rishtarëve shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Fermos (1664-1746) shih DEMIRAJ 2015. Në përpunim e sipër është edhe një studim i ngjashëm i Autorit për Kolegjin Urban të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë.

6 Pjesë të këtij dorëshkrimi janë botuar ndërkohë, të përkthyer në kroatisht: JURIĆ 1982, JURIĆ & KORADE 1983.

7 Listat e rishtarëve për vitet 1580 – 1623 janë gjithsesi të natyrës sporadike, d.m.th. nuk mbulojnë katërcipërisht të gjithë hapësirën kohore në fjalë edhe për të ashtuquajturit rishtarë ilirikë (= it. *alunni ilirici*).

mëngon të botojë një dokumentacion arkivor shtesë me vlera të veçanta, sa u përket masave paraprake dhe vendimeve të Kurisë së Shenjtë që janë marrë përgjatë ecurisë së aktivitetit të këtij kolegj. (2006 [II] 678vv.; [III] 1229vv.) Një lekturë mësimdhënëse i mundësuan shkruesit të këtyre radhëve padyshim një numër punimesh të cemta të Marco Moroni-t mbi këtë temë (2001a, 2001b, 2003), duke dashur të dallojmë me këtë rast sidomos studimin e tij solid: *Il Collegio illirico e l'Albania* (2010), ku autori merr në analizë formimin teologjik-intelektual të rishtarëve shqiptarë në kolegjet ilirike të Fermos dhe Loretos. *Last but not least* lejohe mi të citojmë këtu edhe një prurje të fundit e, pas gjase, të pavarur të At Frrok Zefit (2000 49vv.), i cili përpos paraqitjes me karakter deri diku divulgativ të Kolegjit Ilirik të Loretos na përcjell me stil telegrafik një listë emrash të shqiptarizuar me rishtarë vetëm nga Arqipeshkëvia e Shkupit, të cilët paskan vizituar këtë kolegj në periudhën ndërmjet viteve 1623-1797.

Shfrytëzimi paraprak i letërsisë shkencore ekzistuese nxiti shkruesin e këtyre radhëve të ndërmerrte hulumtime të mirëfillta në tre arkiva historike në Itali, siç janë Archivio Storico della Santa Casa di Loreto (ASSC – maj 2015), Archivium Romanum della Società di Jesù në Romë (ARSI – mars 2015) dhe Archivio Storico della Propaganda Fide në Romë (ASPF – mars 2015), çka i mundësoi jo vetëm verifikimin e materialit të mbledhur, por edhe krehjen, pasurimin, përkatësisht plotësimin e tij. Rezultat i kësaj pune aspak të lehtë ase komode është bash ky punim që i paraqesim lexuesit tonë sqimatar, pa mëtuar assesi një ezaurim tërësor e të patëmetë të studimit, jetës dhe historisë së asaj falange të gjatë të rishtarëve shqiptarë bash në njërin ndër ato kolegje, që në radhë të parë shoqëruan nga afër dhe ndikuan pozitivisht fatet e grigjës së krishterë e të vetë Kishës Katolike Romake në Arealin Kulturor të Shqipërisë së Veriut sidomos përgjatë shek. XVII – XVIII.

2. Collegium Illyricum Lauretanum – themelimi dhe stacionet e tij

Sado provokues që feks e tingëllon sot për sytë e veshët tanë përcaktori i parë i këtij emërtimi *ilirik* (= lat. *illyricum*, it. *ilirico*), ky është realiteti i dikurshëm intelektual, thënë më saktë imagjinata lakuriqe e kohës (edhe) në fund të shek. XVI, bash në vitin 1580, kur u themelua *Kolegji Ilirik i Loretos* (: lat. *Collegium Illyricum Lauretanum*, it. *Collegio Ilirico di Loreto*). Mëtojmë fort në këtë bindje, sepse emërtimi i tij kumton shumë, pra jo thjesht dhe vetëm vendndodhjen e tij shi pranë Sanktuarit të Shtëpisë së Shenjtë të Zojës së Panjollë, që gjeti prehje fatlume pikërisht në Loreto (Le Marche/Itali, dhjetor 1296) pas asaj arratije sa hyjnore, aq edhe turravrap prej Tokës të Shenjtë. Bashkëlidhjen historike vs. mitike me gjymtyrën e parë përcaktuese: *ilirik*, na e siguron pikërisht ajo “ndalesë çlodhëse” e Shtëpisë së Shenjtë diku e dikur në bregdetin dalmat, bash në ato zona

me popullsi romane dhe sllavishtfolëse, që konsideroheshin nga elita intelektuale e kohës si pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve zulmëmëdhenj të Ballkanit Perëndimor. Barinjtë intelektualë shqipfolës të po asaj kohe sigurisht që nuk sillleshin aspak zemërakë e xanxarë në këtë pikë, madje as nuk u shkonte ndër mend atëbotë t'i fusnin xixat njëri-tjetrit për emërtime të asaj natyre; përkundrazi vrisnin më shumë rradaken, si e si të zgjeronin radiusin e pranimit të rishtarëve në këtë kolegji, që vjen me thënë edhe për bashkësinë e krishterë shqipfolëse që kishte rënë ndërkohë tërësisht nën zgjedhën e pushtimit turk, paçka se për punë rrënjësh, trangu e degësh, e sidomos gurre etnike-gjuhësore, këto i kërkonin dhe i gjenin lehtë e mirakandshëm po në antikitetin ballkanik, shi te maqedonasit dhe/ose tek epirotët po aq zulmëmëdhenj sa edhe piratët e dikurshëm të botës ilire.⁸

Sa i përket natyrës së kolegjit, kjo nuk lejon aspak mëdyshje të rastit: mjafton të përmendim këtu emrin e themeluesit të tij, Papë Gregorin XIII, i mirënjohur jo thjesht dhe vetëm për reformimin e Kalendarit të dikurshëm Justinian, ashtu siç e mirëruajmë sot e gjithë ditën si Kalendarin Gregorian, por edhe për numrin e pazakonshëm të plot 23 *Collegia Gregoriana* që mbajnë firmën dhe vulën e tij. Prashtu vijmë tash krejt natyrshëm në funksionin themelor të këtij kolegji, që kishte të bënte në zanafillë, pikërisht me formimin dhe përgatitjen e klerikëve *ilirikë* për “aiutare spiritualmente le Provincie di Schiavonia e di provedere quelli paesi di sacerdoti indonei per la cura dell'anime.”



Foto 1: Fasada e jashtme të Sanktuarit të Shtëpisë së Shenjtë në Loreto
(Demiraj: 15.05.2015)

8 Shih së fundi për këtë problem DEMIRAJ 2014a 16vv.

2.1. Fillimet e kolegjit në Loreto (1580 - 1593)

Në letërsinë shkencore është hetuar e përshkruar ndërkohë kënaqshëm themelimi i kolegjit me kulisat dhe sfondin kulturor e social-ekonomik përkatës që përcolli përfitim e tij. Kështu, lejohemi të përmendim shkurt që nxitjen e parë e dha një tubim sinodal i dioqezave përgjatë bregdetit dalmat (Zarë, maj 1579) në praninë e vizitorit apostolik Agostino Valier, ku doli në pah nevoja e krijimit të një institucioni teologjik-arsimor që do të edukonte klerikë të rinj sipas vendimeve të Koncilit të Trentos, në bashkëlidhje kjo edhe me rrezikun e vazhdueshëm që po përjetonte ndërkohë Kisha Katolike Romake prej zgjerimit territorial dhe influencës së Portës së Lartë në Ballkan. Strehimi i kolegjit pranë sanktuarit të Shtëpisë së Shenjtë në Loreto u fiksua pas gjase jo thjesht e vetëm prej mundësive të financimit të tij me të ardhurat e bollshme që mbledheshin në këtë vend pelegrinazhi europian, por edhe falë atij filli lidhës kulturor historik vs. mitik të sanktuarit me Dalmacinë dhe Ballkanin Perëndimor, si stacion ndërmjetës i asaj odiseje hyjnore të Shtëpisë së Shenjtë. Gjithsesi, nuk ekziston ndonjë dekretim zyrtar me bulë papnore, sa i përket hapjes së tij, përpos do varianteve të një shkrimi me vlerë vendimore (*motu proprio*) të Papë Gregorit XIII dora vetë, i cili jo vetëm dha udhëzimet e rastit për hapjen e kolegjit, por edhe ia besoi drejtimin e tij, përkatësisht zhvillimin e planit mësimor, Urdhrit Jezuit dora vetë, i mirënjohur qoftë për besnikëri ndaj Atit të Shenjtë: Papës, ashtu edhe për programin e mirënjohur si *Ratio studiorum* në fushën e arsimit e të formimit solid teologjik-intelektual.

Kolegji zhvilloi aktivitetin e vet fillimisht në Loreto për 13 vjet me radhë, duke pranuar në këtë fazë të parë pas gjase aty te 130 rishtarë në moshë pak a shumë të pjekur (mbi 20 vjeç), të cilët vinin prej dioqezave bregdetare me popullsi dalmate e që ishin kryesisht nën protektoratin e Republikës së Venedikut, ndër to: Kotor, Bar (= Tivar), Budva, Paštrovići, Dubrovnik, Trogir, Korčula, Hvar, Brač, Omiš, Poljica, Zadar, Rab, Pula, Cres, Krk, Poreč, Senj dhe Rijeka. Për më tepër, koha e studimit në këtë periudhë ishte e kufizuar deri në tre vjet, duke iu përcjellë kështu rishtarëve, përpos dijeve në lëndën e gramatikës (latine) edhe pjesën praktike të teologjisë morale. Praktikrat e predikimit dhe të katekizmit rishtarët i ushtronin si *native speaker* në ngulimet përreth, ku ishin vendosur në vazhdimësi refugjatë dalmatinë (sllavishtfolës) qysh prej gjysmës së shek. XIV. (Kovačić 2003 222v)

2.2. Bartja e kolegjit në Romë (1593 - 1624)

Më 3 qershor 1593 Kolegji Ilirik i Loretos bartet (edhe) zyrtarisht në Romë, fillimisht në Seminarin Roman (= it. *Seminario Romano*), i cili drejtohej gjithashtu prej Urdhrit Jezuit. Arsytet e kësaj zhvendosjeje interpretohen ndryshëm në letërsinë shkencore, ku i mëshohet sigurisht më fort situatës së re që u krijua me këtë rast: a) së pari me pasoja negative

për dioqezat përkatëse në Ballkanin Perëndimor, meqë numri i rishtarëve, për shkak të shpenzimeve më të mëdha në këtë qendër kryesore urbane, u rrudh në 12 në vit, e b) së dyti me zgjatjen potenciale të studimit, d.m.th. të përfitimit individual të vetë rishtarëve, të cilët ndiqnin tashmë shkollën e lartë publike të jezuitëve, ku pas gjase mund të kompletinin formimin e tyre me kurse të plota në filozofi e teologji e për rrjedhojë të mëtonin edhe fitimin e gradave shkencore akademike.

Kjo situatë e re nuk mund të shoqërohej ndryshe veçse me varje buzësh e hundësh prej ipeshkvijve dalmatinë, sepse këta ishin fort të interesuar të siguronin sa më shumë e sa më shpejt barinj shpirtërorë që do të kujdeseshin për grigjat e veta në ato treva. Një fatkeqësi natyrore që ndodhi në prag të Kërshëndellave të vitit 1598 i shtoi një brengë më shumë shqetësimit të tyre: ishte pikërisht përzjerja me nxënës laikë, meqë një vërshim i papritur dhe i pamasë lumit Tevere shkatërroi plotësisht ambientet e Seminarit dhe të Kolegjit Roman,⁹ kështu që shpërngulja e rishtarëve ilirikë në Kolegjin Klementin (= lat. *Collegium Clementinum*) në Romë, që ishte nën mbikëqyrjen e etërve somaskitë, u bë fakt i kryer për 25 vitet e ardhshme. Janë pikërisht këto rrethana që lejojnë edhe studiuesit ta klasifikojnë këtë periudhë si më pak të pëlleshmen, sa i përket formimit të barinjve shpirtërorë ilirikë në këndvështrimin skolastik e sidomos atë edukativ-shpirtëror.¹⁰

2.3. Kthimi përfundimtar në Loreto (1624 - 1798)

Themelimi i Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë (1622) hapi një fazë të re në mbarëvajtjen e kolegjit, i cili më 1624 u kthye rishtas me lang e me plang në Loreto. Riorganizimi i kolegjit u realizua në mënyrë të tillë, sa që shumëkush mëton sot në debatin shkencor, se kemi të bëjmë thjesht me një rithemelim të tij. Për këtë sillel si argument pozitiv roli vendimtar i Papë Urbanit VIII, i cili sigloi tre vjet më pas, më dt. 1 qershor 1627, me bulë të posaçme (*Zelo domus Dei*¹¹) riorganizimin e këtij kolegji e me qëllimin afatgjatë për t'i ardhur në ndihmë në vazhdimësi jetës së krishterë jo vetëm zonës ilirike-dalmatine, por gjithë atyre trevave ballkanike që ishin bërë ndërkohë pjesë e Perandorisë Osmane. Këtë e dëshmon edhe fiksimi në bulën papmore i numrit të studentëve me të paktën 20 rishtarë në vit (: *viginti saltem alumnorum*).

9 Rishtarët ilirikë ishin vendosur derimëatëherë në ambientet e këtij seminari (= it. *Seminario Romano*), që ndodhej pranë Kolegjit Roman (= lat. *Collegium Romanum*, it. *Collegio Romano*), duke iu vënë aty në dispozicion për programin mësimor sallën „San Girolamo”. Për konfuzionin e përfutur në letërsinë shkencore ndërmjet këtyre dy emërtimeve shih KOVAČIĆ 2003 242v. (shën. 31)

10 Hollësisht JURIĆ (1932) 1982 41v.

11 Shih ndër të tjerë MORONI 2001b 193; KOVAČIĆ 2003 224 dhe 243, shën. 35.



Foto 2: Ish-ndërtesa e Kolegjit Ilirik të Loreto-s
(Demiraj, dt. 17.05.2015)

Drejtimi i kolegjit dhe funksionimi i tij iu la në dorë rishtas Urdhrit Jezuit, sigurisht deri në vitin 1773, kur ky urdhër u suprimua prej Kurisë së Shenjtë. Pas kësaj ngjarjeje drejtimi i kolegjit kaloi për rreth 25 vjet nën mbikëqyrjen e korpunit drejtues të Shtëpisë së Shenjtë në Loreto, deri në muajt e parë të vitit 1798, kur trupat pushtuese të Napoleonit kishin hyrë ndërkohë në trevat e shtetit pontefikal (Le Marche), duke pezulluar përfundimisht aktivitetin e tij zanafillës, përkatësisht duke i ndryshuar destinacion edhe ndërtesës, ku ishte vendosur ai.¹²

2.4. Collegium Illyrico-Picenum (1834 – 1860)

Zhvillimet politike-ushtarake në Europë përgjatë dy dhjetëvjeçarëve në vazhdim nuk premtinin aspak ndonjë ndërmarrje të re për të rihapur kolegjin. Dritë jeshile u hap vetëm me Kongresin e Vjenës (1814/5) që rivendosi statusin e shtetit pontefikal e vetëm pasi përfunduan punimet e rinovimit të ndërtesës thuhet plotësisht të shkatërruar të atij kolegji, përkatësisht me nënshkrimin dhe shpalljen e bulës *Paterna sollicitudo* të Papë Grigorit XVI më 29 shtator 1834.¹³ Kolegji do të vazhdojë kështu të mbijetojë deri në vitin 1860, veçse me një fasetë të re programi mësimor, i cili iu la rishtas ta drejtonte Urdhri Jezuit. Për më tepër kolegji erdhi e u pagëzua me emërtimin vendor shtesë *Collegium Illyrico-Picenum*, meqë jo vetëm programi (jo më ai klasik), por edhe përbërja dhe destinacioni i tij ndryshonin. Kështu, nuk pranoheshin tashmë në kolegji më shumë

12 Hollësisht Kovačić 2003 235vv.

13 Gjithsesi, prej vitit 1822, Kongregacioni i Sanktuarit të Shenjtë financonte për llogari të Kolegjit Ilirik të Loretos katër vende studimi në Kolegjin Urban të Romës. (Kovačić 2003 239)

se 12 rishtarë të ashtuquajtur *ilirikë*, ndërkohë që pjesa tjetër mbulohej me 12 rishtarë të zonës përreth (= it. *Piceno*). Situata e re politike dhe krijimi i Italisë si shtet i bashkuar e sovran, bëri që në vitin 1860 të mbyllej përfundimisht historia përgjatë tre shekujsh e Kolegjit Ilirik të Loretos. Hapja e mëvonshme (1925) e një seminari të vogël kishtar vetëm sa përkujton një periudhë tashmë të kapërcyer të formimit fetar-intelektual të klerikëve të rinj me destinacion misionin e dikurshëm baritor në trevat ballkanike. (shën. 14) Tashmë këtë kujtesë e mban gjallë vetëm pllaka me emrin mbresëlënës *Collegium Illyricum* të asaj ndërtese po aq mbresëlënëse në Piazza della Madonna në krah të Basilikës së Shtëpisë së Shenjtë në Loreto, që në vitin 1968, i pagëzuar si “Palazzo Illirico”, u shndërrua në seli dhe strehë (it. *ospizio*) për pelegrinë të sëmure¹⁴ – sot sigurisht me kuletë të rënduar!!! –, të cilët vijnë, shohin dhe shpresojnë të gjejnë shërim fatlum sipas maksimës njerëzore: lat. *dum spiro, spero* (Cicero)



Foto 3: “Palazzo Illirico”
(Demiraj, më 17.05.2015)

3. *Ratio studiorum* dhe mundësitë e zbatimit të tij në kolegji

Emri i mirë i Urdhrit Jezuit në bashkëlidhje me kolegjin tonë ka të bëjë me sendërtimin në vazhdimësi të programit mësimor *Ratio studiorum*, i zhvilluar si i tillë dikur (përfundimisht më 1599) prej gjeneralit të atij urdhri, Claudio Aquaviva S.J. Është pikërisht ky personalitet i kohës që citohet shpesh në letërsinë shkencore edhe për fatet e themelimit dhe të zhvillimit që përjetoi më pas vetë Kolegji Ilirik i Loretos. Veçse në fillimet e veta e sigurisht në përputhje me qëllimin zanafillës, sa i përket përgatitjes sa më të shpejtë të rishtarëve për aktivitet baritor (shih më lart § 2.1), ky program – edhe pse ende në shpërgën – nuk u zbatua qysh në fillim në plotësinë e vet. Këtë plotësi e fiksoi me akt vendimor bula e vitit 1627 me

14 Shih GRIMALDI 2006 355v.

ideator Papë Urbanin VIII, e cila mëtonte zhvillimin e kurseve të rregullta në atë kolegji: “... *in grammaticae, philosophicae et theologiae ac sacrorum canonum aliarumque facultatum necessitates illyricas concernentium, disciplinis ac studiis instrui ...*”.

Në bashkëlidhje me dy kurset e fundit, që vjen me thënë në formimin solid në fushat e filozofisë e të teologjisë, e për vetë natyrën e tyre si shkalla më e lartë e formimit intelektual, Papa Urbani VIII iu referua në bulën e tij bash atyre privilegjeve që gëzonte universiteti i Romës (me programin: *Studium generale Almae Urbis*) e ndonjë kolegji tjetër i asaj kohe, duke i dhënë rektorit të këtij kolegji – sigurisht në bashkëpëlqim me kardinalin fuqiplotë (= it. *protettore*) të Loretos – të gjitha të drejtat për të akorduar gradat akademike përkatëse, ndër to: shkallën *bachelor* (= it. <baccalaureato>), licencën e përfundimit të studimeve themelore, diplomën (= it. <laurea>) e doktoranturës, përkatësisht atë të magjistrisë (= “mësues në filozofi dhe teologji”).

3.1. Përzgjedhja e rishtarëve dhe radha e studimit në kolegji

Përzgjedhja i rishtarëve në kolegji zhvillohej së pari nëpërmjet disa udhëzimeve që duhej të mbanin parasysh ipeshkvijtë e atyre dioqezave që kishin të drejtë t’i dërgonin sipas radhës përkatëse. Kështu p.sh. i aftë konsiderohej një djalosh rreth moshës 16 – 20 vjeç, i shëndetshëm e mundësisht shtatlartë e i pashëm dhe që dukej të kishte aftësi e dëshirë për të studiuar e për të ecur në rrugën e vështirë të bariut shpirtëror. Kushtet e vëna për paraqitjen e jashtme nuk i përmbushte assesi një fëmijë udob dhe ulok, me shpërbërje, vrasa lije a cene të ndryshme në fytyrë e trup, ase me shenja epilepsie. Sa i përket formimit shkollor, parapëlqeheshin ata rishtarë potencialë që kishin fituar ndërkohë njohuri të thelluara në shkrim e lexim në gjuhën e vendit, por sidomos në gramatikën e italishtes. Përgjashtoheshin nga kjo kërkesë parësore vetëm ata rishtarë që vinin nga ato treva që ishin pjesë e Perandorisë Osmane e ku pas gjase mungonin mundësi të tilla formimi.

Paraqitja në kolegji nuk parakuptonte patjetër statusin e veçantë të ‘nxënësit’ të tij (= it. *alunno*, shq. *alun*), ku secili ishte i pajisur me uniformë dalluese. “Kurset kundër analfabetizmit” (= mësimi i italishtes dhe formimi humanist paraprak) zhvilloheshin gjatë dhe rishtarët jetonin në konvikt, ndarë veças prej alunëve. Atyre që e kalonin këtë përgatitje paraprake dhe dukeshin të ishin të prerë për të studiuar, fillonin më pas menjëherë me kurset e latinishtes. Pas përfundimit me sukses të lëndës së gramatikës (= latine), çka mund të zgjaste deri dy vjet, rishtarët ishin të detyruar të bënin: thonin, shkruanin dhe nënshkruanin betimin: a) se do t’i nënshtroheshin tërësisht rregullores së brendshme të jetës në kolegji e se çdo gjë, qoftë edhe lëvizjet jashtë tij, përcaktoheshin dhe saktësoheshin vetëm me leje të posaçme të rektorit; b) se nuk do të sorollateshin dyerve të familjeve

fisnike: “alle corti de principi e case de grandi per trattenervisi lungo tempo, nemmeno alle università o altre scuole pubbliche sotto qualunque preteso, se non quando così giudicassero, ovvero volessero li superiori con licenza espressa in scritto.”; c) se pas mbarimit me sukses të studimeve në kolegji do të ktheheshin në atdhe, përkatësisht në dioqezat që i kishin aty; dhe d) se do të ishin gjithherë në dispozicion të ipeshkvit të asaj dioqeze, duke iu bindur pa kushte vendimit dhe urdhrave të tij.

Pas ndjekjes me sukses të kurseve të gramatikës dhe betimit, rishtarët ndiqnin sipas radhës kurse (zakonisht) dyvjeçare të retorikës, filozofisë dhe teologjisë skolastike e morale, duke përmbushur kështu një formim fetar-intelektual të patëmetë që normalisht zhvillohej në një hapësirë kohore 6 deri 10 vjet, në varësi kjo me shkallën përgatitore të secilit rishtar para hyrjes në kolegji. Bëjmë fjalë këtu gjithherë për fazën e dytë të aktivitetit të Kolegjit Ilirik në Loreto, pra pas shpalljes së bulës së Papë Urbanit VIII (1627) e që vijon deri në fund të shek. XVIII, deri në vitin 1798, kur në Loreto hyjnë trupat franceze të Napoleonit, duke pezulluar edhe aktivitetin e tij.

Pas dhënies së betimit, realizimi i programit mësimor shoqërohej gjithashtu paralelisht me ngjitjen e shkallëve në hierarkinë e formimit meshtarak, ku fitoheshin sipas radhës: a) katër urdhrat meshtarakë; b) statusi i nëndiakonit; c) statusi i diakonit; dhe së fundi d) shugurimi priftëror. Ata nxënës që nuk dukej të kishin shansin për të zhvilluar me sukses deri në fund atë program, kalonin në studim të reduktuar: “casi di coscienza” dhe ktheheshin në atdhe me atë status (= it *casista*), gjithmonë me shpresën dhe dëshirën e mirë, që mbarëvajtjen e tyre në punë të meshtarisë dhe karrierën e mëtejshme baritore ta përcaktonin dhe ndiqnin nga afër ipeshkvijtë përkatës të trevave nga vinin.

3.2. Zgjidhje alternative sipas kohës dhe rastit

Miratimi i një programi të tillë nga Selia e Shenjtë, madje vetë kreu i saj Papa, sigurisht që do të krijonte vështirësi të rastit, meqë edhe numri i rishtarëve thua jse asnjë vit shkollor nuk do ta kalonte shifrën 20,¹⁵ çka vjen me thënë që ndonjë kursi mësimor të parashikuar, i binte jo rrallë të mos kishte fare nxënës, ose numri i tyre do të ishte aq i rrudhur, sa vërtet vihej në pikëpyetje rentabiliteti i mësuesve me u angazhuar për to. Prashtu, nuk duhet të bëjmë aspak çudi që do rishtarë u transferuan në Romë, kur aty u hap Kolegji Urban (= lat. *Collegium Urbanum*), për të vijuar në të kurset e teologjisë. I tillë është p.sh. nxënësi më i parë i regjistruar në atë kolegji të ri: Frang Bardhi (= <Franciscus Blanchus>) dora vetë, i cili u paraqit aty së bashku me Shtjefën Gasprin (= <Stephano Gasparo> – i treti në listë) më dt. 12 qershor 1633 për t’u dhënë fund njëherë e mirë të dy me sukses

15 Numri më i rrudhur regjistrohet në vitin 1745 me gjithsej 12 nxënës. (Kovačić 2003 225)

studimeve në kursin e fundit të teologjisë skolastike dhe morale.¹⁶

Numrit relativisht të pakët të rishtarëve i shtohet sipas kohës dhe rastit edhe niveli i ndryshëm i aftësisë së përfitimit të çdo rishtari në veçanti, përkatësisht faza përgatitore e secilit syresh para se të hynin në kolegji. Kështu p.sh. nuk mungonin të tillë rishtarë që vinin sidomos prej trevash nën pushtimin osman, të cilët ose kishin formim të mangët ose ishin thuajse analfabetë. I tillë ishte <Tommaso Cristich> nga Beogradi që erdhi në Loreto më 1663 pa pasë studiuar diçka më parë: “cosa alcuna”. Të tillë ishin po ashtu edhe dy rishtarët shqiptarë Pjetër Valmi prej Dioqezës së Sapës dhe Dhimitër Izi (= <Izi>) prej simotrës së Lezhës që u regjistruan në kolegji më 1665 pa njohuri të italishtes, madje “senza cognizione di lettere”. Diçka më shumë “un po’ di leggere” kishte mësuar Gjergj Kuka (= <Giorgio Cucca>) nga Kruja që hyri në kolegji më 1658 në moshën plot 20 vjeç. Të njëjtën situatë mësojmë prej rektorit të kolegjit edhe një shekull më pas, më 1758, lidhur me Pjetër Zogajn (= <Pietro Sogagni>) nga Gjakova, i cili kishte dy vjet që studionte në kolegji pa mundur të mësojë ende siç duhet italishten.¹⁷

Asgjëmangut, shumica e nxënësve ecte mirë në mësim, madje shumë syresh ishin aq të motivuar, sa përpos ecurisë së rregullt në programin mësimor, synonin të zgjeronin njohuritë e tyre në fusha të tjera, që nuk ishin parashikuar në program. I tillë rezulton të ketë qenë p.sh. Pjetër Bogdani, i cili nuk mungon të kërkojë me kryer studime shtesë në fushën e mjekësisë, përkatësisht atë të fizikës.¹⁸

Sa i përket marrjes së gradave akademike, kolegji nuk filloi të shpërndante menjëherë syresh, edhe pse bula papnore *Zelus domus Dei* kishte parashikuar sosh qysh më 1627. Kështu, shumë rishtarë me origjinë shqiptare, si p.sh. Frang Bardhi, Shtjefën Gaspari apo Pjetër Bogdani ishin të detyruar ta fitonin këtë shkallë akademike në Romë, në Kolegjin Urban.¹⁹ I pari rishtar (= <alunno>) që përjetoi gëzimin e titullit “dottore in filosofia e teologia” në Loreto ishte Giorgio Parschych prej Dioqezës së Sebenico-s më dt. 9 qershor 1681. Nga kjo datë e deri në vitin 1797 e gëzuan këtë gradë akademike shumë të tjerë, ndër ta edhe rishtarë shqiptarë si p.sh. Gjon P. Nikollë Kazazi apo Gjon Bogdani.²⁰

16 JEZERNIK 1971 479 dhe DEMIRAJ: Grimca biografike për autorët tanë të vjetër I. Frang Mark Bardhi (1606 – 1643) (15 f. – në shtyp)

17 KOVAČIĆ 2003 228: „... venuto da lontano paese affatto privo di lettere e di così dura capacità che in due anni di dimora neanche abbia appreso la lingua italiana ...”

18 MARQUET 1997 33 (me shënimin e burimit arkivor: ASPF SC Visite e Collegi 1648, vol. 29, fol. 51r.

19 Doktorimi i Bogdanit në Romë është pasqyruar deri sot më mirë përmes dokumentacionit arkivor, khs. MARLEKAJ 2008² 26v.

20 Lidhur me titullin e Kazazit shih EUBEL 1958 (VI) 370, dhe hollësisht DEMIRAJ 2006 37vv.; 2013 29vv. Për Gjon Bogdanin shih më poshtë § 6.2.1.

3.3. Jo gjithçka rrjedh si në vaj

Realizimi i programit mësimesor dhe përfitimi prej tij, sikurse bindja e padiskutueshme ndaj eprorëve ishte sigurisht vetëm një aspekt i jetës, me të cilën duhej të përballeshin për vite të tëra rishtarët në kolegji. Vështirësive aspak të vogla për t'u mësuar me këtë jetë u shtohesh sipas rastit klima aspak e shëndetshme në Loreto, e cila jo vetëm ndryshonte shumë nga ajo e vendeve nga vinin, por ishte edhe një faktor shtesë që e rëndonte stresin e jetës në kolegji. Andaj nuk ishte rastësi që dikush duhej të ndërpriste studimet për arsye shëndetësore për t'u kthyer në vendlindje, ose në rastin më të pafat të mbyllte jetën e vet në Loreto. Sëmundja më e rëndomtë, prej së cilës gjithkush frikohej sa i dëgjonte emrin ishte veremi (= *tuberkulozi*, it. *tisi*). Ishte pikërisht kjo sëmundje që e rëndonte shumë jetën e të rinjve në zonat përreth e për rrjedhojë edhe atë në kolegji deri në mes të shek. XIX. Këtë fat pati p.sh. <Jacomio Isij> (= shq. /Jak Izi/) prej Lezhe, i cili hyri në kolegji më 5 qershor 1629 në moshën 16 vjeç, dhe u desh të largohej pas gjashtë vjetësh, më 15 prill 1635 për arsye të gjendjes së rënduar shëndetësore e me shpresë se, duke ndryshuar klimë, aty do të përmirësohej. (§. 6.2.1., nr. 12)

Një tjetër problem i jo pak të rinjve që vinin në kolegji ishte edhe ambientimi në kushte jetësore që nuk gjasonin aspak me ato të vendlindjes, sidomos për ata që vinin prej zonave të thella e malore të Ballkanit. Për ta nuk mjaftonte thjesht dhe vetëm rruga e gjatë e plot rreziqe deri sa mbërrinin në Loreto, por sidomos jeta kolektive dhe e disiplinuar në kolegji. Kjo i bënte ata shpesh të tregonin padurim dhe mosbindje ndaj eprorëve. Nuk mungonin këso rastesh jo vetëm thyerjet disiplinore brenda në kolegji, dënimet me izolim të përkohshëm, deri edhe tentativat serioze për t'ua mbathur nga sytë këmbët, të cilat në shumësinë e rasteve përfundonin me izolim dhe kthim të detyrueshëm në vendlindje. Ndër statistikatat që ruhen për vitet 1627-1686, rezultojnë që ndër 280 nxënës që hynë në kolegji këtë periudhë, dhjetë i lanë atij pendët, duke marrë arratinë, nëntë “u liruan” me mirëkuptim, duke i kthyer për në vendlindje si të paaftë, përkatësisht të lodhur ase të pamundur, ndërsa tetë të tjerë “u dëbuan” nga kolegji si të pandreqshëm; pra as më shumë e as më pak por plot 10% e numrit fillestar.²¹ Sigurisht që do syresh tingëllojnë jo vetëm me mbiemër shqiptar, por vinin bash prej atyre trevave. I tillë është p.sh. <Demetrio Bianchi> (= /Dhimitër Bardhi/) prej Zadrime, i cili hyri në kolegji më dt. 25 gusht 1635 dhe ia mbathi nga sytë këmbët (§ 6.2.1., nr. 18), apo patrioti i vet <Georgio Scura> (= /Gjergj Skurra/) prej Lezhe, i cili u përzu nga kolegji më 16 gusht 1744 si zullumqar i pandreqshëm (§ 6.2.1, nr. 19)

21 Ndër ata që u dëbuan për veprime e akte të rënda ndaj eprorëve shumicën (rreth 75%) e përbënin rishtarët që vinin nga zonat nën sundimin otoman. (Kovačić 2003 227)

4. Elementi shqiptar në fokusin e historisë së kolegjit

Siç vumë në dukje në hyrje të punimit, ky element nuk ishte parashikuar në zanafillë të ngërthehej patjetër në aktivitetin e kolegjit të ashtuquajtur *ilirik*, meqë vetë iniciativa e themelimit u ndërmor prej atyre dioqezave përgjatë zonës së po-ashtuquajtur ilirike në bregdetin dalmat e me popullsi të përzier kryesisht romane dhe sllavishtfolëse. E kjo situatë duket të ketë mbizotëruar sidomos në fazën e parë: a) Loreto (1580 – 1593) dhe b) Romë (1594 – 1624), kur kolegji funksiononte në bazë të masës vendimore (*motu proprio*) të Papë Gregorit XIII, në të cilën u lihej pak ose aspak hapësirë dioqezave me ngjyrim tjetër etnik-gjuhësor, siç ishin në rastin konkret ato me popullsi katolike kryesisht shqipfolëse më në jug (*Dheu i Arbënit*) e më në qendër (*Kisha Metropolitane e Ohrit dhe Arqipeshkëvia e Shkupit*). Gjithsesi, edhe për to nuk munguan atëbotë përpjekjet me i parë e ardhur në ndihmë, bash kur dështoi projekti kompensues i hapjes së një *Collegio albanese*.

Dështimi i këtyre përpjekjeve (shih § 4.1.), bëri që ky element të shtonte në vazhdimësi praninë e tij në Kolegjin Ilirik të Loretos, ashtu siç u fiksua sidomos në fazën e tij të dytë me shpalljen e bulës *Zelo domus Dei* me nënshkrues Papë Urbanin VIII dora vetë, e në të cilën parashikoheshin edhe dy vende për dioqezat shqiptare Tej- dhe Këtej-Drinit (*citra et ultra Drinum*).²² Këtyre dy vendeve iu shtuan me kohë e sipas rastit edhe *Alunnato Albani* (= “Bursa Albani”), një vend ky i përfutur me ndërhyrjen e Papë Klementit XI (= *Papa Albani* “Papë Shqiptari”) menjëherë pas mbajtjes së Kuvendit të Arbënit (Mërqinjë, janar 1703), e më pas në gjysmën e shek. XVIII me një vend shtesë si *locus supranumerarius* për Arqipeshkëvinë e Shkupit, i cili mbulohej me shpenzimet e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, sikurse edhe *Alunnato Vladagni* (= “Bursa Vlladanji”), një vend ky i përhershëm (prej vitit 1728), për Dioqezën e Shkodrës që financohej privatisht prej familjes i shkodrane Vlladanji.

Një rol sado anësor në jetën e këtij kolegji, sidomos në fund të shek. XVIII, pikërisht në periudhën e vështirë të ndërhyrjes së trupave franceze në Loreto, ka luajtur pas gjithë gjasash edhe Conte Andrea Angeli Radovani që vepronte atëbotë në portin e Ancona-s në funksionin e konsullit të Mbretërisë së Spanjës.

Le të ndalemi thukët në disa ndër këto çështje, të cituara më lart.

4.1. “Collegio albanese” – një përpjekje e dështuar

Hapja e Kolegjit Ilirik në Loreto dhe përgatitja paraprake vete barinjve shpirtërorë vetëm për qytetet-porte në bregdetin dalmat, sigurisht që nuk u prit nga gjithkush me përgëzime të rastit: një pjesë e tumirën me rrudhje buzësh dhe veshë- e symbyllur. Kritikë ushtroi qysh në fillim rektori i parë i

22 Shih ndër të tjerë MORONI 2010 170 (me të dhëna bibliografike mbi botimin e leximit të kësaj bule: THEINER 1875 II, 124vv, § 3-6)

këtij kolegji, raguzani Tommaso Ragio SJ dora vetë, i cili më 1584 bashkë me vizitorin apostolik <Alexandar Cumullouich> pati rast të bridhte zona të tëra të hinterlandit ballkanik nën sundimin osman e ku mjerimi i popullsisë së krishterë, përkatësisht përballja e pabarabartë e Kishës Katolike-Romake qoftë me Islamin ashtu edhe me Kishën Ortodokse rrezikonte seriozisht humbjet e saj masive në kohë dhe hapësirë. Për më tepër Urdhri Jezuit ndiqte tjetër strategji lidhur me synimin largvajtës të Kolegjit të Loretos, sepse nga njëra anë: “si considerò che il più sicuro modo per impadronirsi del Paese, et il più riuscibile, era [...] gente di questo seminario per quelle terre, città e ville, dove sono Cristiani della nazione di rito latino et massime nelle parti più centro del Paese et più vicine a Costantinopoli”.²³ Nga ana tjetër, siç thekson Ragio në relacionin e tij, ishin pikërisht këto zona, ku kishte më shumë nevojë për barinj shpirtërorë. (Moroni 2010 162) Është pikërisht kjo një prej arsyeve kryesore që kardinali Giulio Antonio Santori, i ngarkuar atëbotë për reformimin e konventave basiliane në Italinë e Jugut si edhe referent për përballjen e ritit grek me atë latin në Gadishullin Ballkanik, t’i përcillte Kurisë së Shenjtë kërkesën e hapjes edhe të një kolegji të mirëfilltë shqiptar: *Collegio albanese*, krahas atyre ekzistues: *Collegio Greco* në Romë dhe *Collegio Ilirico* në Loreto.

Nuk mungojnë me këtë rast as planet afatgjata, që ky kolegji i ri të kishte mundësi të strehonte rregullisht 25 deri 30 rishtarë, madje si vend i përshtatshëm propozohej Bari ose Lecce, duke parapëlqyer sidomos këtë të fundit meqë: “saria più comodo Lecce, perchè la città non è sul mare come Bari, dove capitando mercanti di Levante facilmente verrebbero in cognitione di questo Collegio et ne potrebbero dar nuova a’ Turchi.”²⁴ Kjo dëshirë e mirë nuk u vu dot në jetë me vullnet po aq të mirë, sepse së pari Papa Gregori XIII – i mirënjohur si “dorëlëshuar”, sa i përket hapjes së plot 23 kolegeve fetare në kohë të vet – na ndërroi jetë bash atëherë kur s’duhej ta bënte atë punë (më 10 prill 1585), ndërkohë që problemi i mbetur pezull u zgjidh disi ndryshe më vonë me caktimin e vendeve për rishtarë të dioqezave shqiptare si në Kolegjin Ilirik të Loretos (zyrtarisht më 1 qershor 1627) ashtu edhe më pas me hapjen e Kolegjit Urban (Romë, zyrtarisht më 1 gusht 1627) e sidomos me hapjen e Kolegjit Ilirik të Feros (1663 – 1746).²⁵

4.2. Bursa Vlladagni – një përpjekje e suksesshme

Një vetëtimë fatndjellëse në qiell të kthjellët – vetëm kështu mund ta përcjellim gjestin unik në jetën treshekullore të kolegjit, kur në dhjetor

23 MORONI 2010 162 (me citim të burimeve arkivore: ARSI Rom, 122)

24 Shih MORONI 2010 163, ku citon JURIĆ (1932) 1982 23vv. Hollësi lidhur me idenë e themelimit të këtij kolegji do të kumtohen në një punim të veçantë të autorit të këtij shkrimi.

25 DEMIRAJ 2015 426vv.

të vitit 1727, ipeshkvi i atëhershëm i Dioqezës së Lezhës dhe rishtar i dikurshëm i Kolegjit të Loretos, troket në derë të kolegjit me një qese të rëndë monedhash ari e me vlerë pas gjase atëbotë marramendëse në plot 1800 skuda. I kishte mbushur mendjen të vëllait i shkodran që ta lehtësonte disi qesen e vet, çka vjen me thënë në kohën tonë “të sponsorizonte” një vend të veçantë në kolegji si it. *Stipendiato Vladagni* bash për Dioqezën e Shkodrës, ase siç shkruhet pak a shumë në dokumentacionin e arkivit: “[...] conoscendo il gran bisogno che tiene la sua diocesi dell’operarii evangelici, ha convinto suo fratello a fondare un alunnato nel Collegio Illirico di Loreto.” Ky vend shtesë ishte menduar që të mbulohej shi me ato interesa të përvitshme që do të fitoheshin normalisht me depozitim të kësaj shume në bankën papnore. Ishte një iniciativë private kjo që mbeti unikale jo vetëm para dhe gjatë gjithë periudhës klasike, kur funksionoi Kolegji Ilirik i Loretos si i tillë (-1798), por deri sot e gjithë ditën në hapësirën kompakte shqipfolëse. Pas gjase ishte kjo një arsye e fortë, që, edhe pse kjo shumë nuk i mbulonte plotësisht interesat bankare të një viti, rektori i kolegjit u entuziazhua aq shumë sa mori vetë përsipër, përkatësisht ndërhyri personalisht në arkën e kolegjit, për pjesën shtesë, meqë: “forte è il bisogno che hanno quegli oppressi cattolici d’essere confermati nella fede cattolica ed aiutati, stando sotto il tirannico giogo de’ Turchi.”²⁶

4.3. Conte Andrea Angeli Radovani – në rolin e ndihmëtarit

Një kont me mbiemrin Radovani që jetonte në fund të shek. XVIII në Ancona, bash me funksionin e lartë të konsullit të Mbretërisë së Spanjës? Që një personalitet i tillë në Ancona si qendra kryesore urbane e Shtetit Pontifikal në gjithë zonën Le Marche – pra edhe për Loreton – të ketë luajtur një rol të tillë në atë fundshekull, nuk ka përse të tjerë fije dyshimi, përderisa këtë kohë e gjithë zona sikurse vetë Europa u rrokën nën autoritetin e pacenueshëm të Napoleon Bonopartit. Në historinë e Europës ky emër gjithsesi lidhet pikërisht me rolin e ndërmjetësit midis Napoleonit dhe Mbretërisë së Spanjës, në mënyrën që të mos zhvilloheshin veprime luftarake të kota, përderisa trupat franceze kishin të tjera plane: bash me zbarkuar në Egjipt në konfrontim ushtarak me Portën e Lartë, e në këtë rast sigurisht që armiku i përbashkët, sulltanati turk kishte përparësi për t’i ngrënë kokën. Por çlidhje ka ky rol me studimin tonë?

Së pari lejohemi të identifikojmë prejardhjen e tij: Zullume tinëzare të kësaj natyre sigurisht që sulltani nuk i toleronte kollaj, andaj s’e bëri as të gjatë, por vendosi të shuajë gjithë fisin Radovani: “vorrebbe estinguere

26 Shih MORONI 2010 171. Në bazë të kërkimeve tona, këtë bursë rezulton ta kenë përfituar rregullisht (deri në vitin 1798) rishtarë me mbiemrin <Vladagni>, përpos një rasti të vetëm, kur me këtë bursë paraqitet dhe studion në kolegji një rishtar me emrin <Joseph Borizzi ~ Giuseppe Boricci> (= /Zef Boriçi/) prej Shkodre. (shih § 6.2.2)

la Razza dei Radovani". Këtë kumt ogurzi e mësojmë, ndër të tjerë, edhe prej Bartl-it,²⁷ i cili na orienton tash të gjejmë rrënjët dhe degët e lisit të tij të gjakut, që rriteshin shëndetshëm në dioqezën e Shkodrës, më saktë në Shirokë, ku gjëllinte familja e tij e madhe. Atësia e vet: Engjëlli (= <Angelus>) ndihmon të zhbirilojmë edhe më shumë, pasi Ndreu ynë rezulton të ketë pasur të paktën edhe dy vëllezër të tjerë, të cilët i ishin përkushtuar jetës baritore me mbarështuar grigjën katolike në Dheun e Arbënit. Prashtu, bash në këtë periudhë kemi Gjergj Engjëll Radovanin (= <Giorgio Angeli Radovani>), ish nxënës i Kolegjit Urban dhe autor tekstesh shqip,²⁸ i cili ishte ngjitur ndërkohë në katedrën e arqipeshkvit të Tivarit, dhe Ndue Engjëll Radovanin (= <Antonio Angeli Radovani>), që vepronte po ndërkohë si ipeshkëv i Dioqezës së Sapës. Në këtë rast, zemëratës së sulltanit nuk arriti t'i shpëtojë dot vetëm i dyti, i cili së bashku me të tjerë (familjarë), pasi u arrestuan nga pasha Bushatlli i Shkodrës, u dërgua pa një e pa dy në Stamboll.

Pa dashur aspak të joshim vëmendjen e lexuesit në tjetër drejtim, po mjaftohemi me kaq, d.m.th. me fiksimin e identitetit etnik-gjuhësor të Kont Ndre Radovanit (në Ancona),²⁹ çka na lejon të vijojmë tash me angazhimin e tij në fatet e Kolegjit tonë Ilirik, pra me i dhënë kuptim edhe ndërkalljes së kësaj figure në mjedisin e studimit tonë. Për fat, ky angazhim është i dokumentuar relativisht mirë në dy momente kyçe gjatë viteve 1797-1798, pikërisht kur trupat franceze erdhën e u bënë zot (edhe) të Loretos, duke dashur edhe aty të "reformojnë" sidomos jetën sociale-shpirtërore rreth e përreth Sanktuarit të Shenjtë.

Momenti i parë i ndihmës na shfaqet shi kur trupat hynë në Loreto dhe trupi mësimor sikurse edhe nxënësit, sidomos ata të klasave të ulëta ua mbathën nga sytë këmbët, si dhe ku të mundnin. Ishte pikërisht ndërhyrja e kontit që i mbledhi këta nxënës të gjithë bashkë, duke mundur t'i strehojë për do muaj në Ancona e duke u rrekur njëherësh të ndërmjetësonte në të mirë të vijimit të aktivitetit tradicional të kolegjit. Kjo ndërmarrje pati sukses qoftë edhe të përkohshëm, meqë pas dy muajsh nxënësit u rikthyen të qetësuar në kolegji dhe u lejuan të vijojnë me po aq qetësi studimet si më parë.

Momenti i dytë na shfaqet muajt e parë të vitit 1798, kur lidhi sythet e veta sado përkohësisht Republika Romane (= it. *Repubblica Romana* – 1798/9) dhe fati i kolegjit u siglue një herë e mirë me mbyllje. Angazhimi i Kont Radovanit "u rrudh" tashmë në përpjekjen aspak të lehtë për t'u

27 BARTL 2014 79v., me dokumentacionin arkivor përkatës 371v.

28 NDRECA 2008 161; DEMIRAJ 2011 79vv.; 2014b 425vv.

29 BARTL (2014 80) sqaron që ndërhyrja e shumë përfaqësive diplomatike evropiane pranë sulltanit e zbuti disi zemëratën e tij. Ipeshkvi me pesë të arrestuar të tjerë u liruan, ndërkohë që vetëm një nip i vet u internua në ishullin Lemnos.

mundësuar shumë nxënësve të kolegjit kthimin shëndoshë e mirë për në vendlindje, i cili për gjendjen e luftës që sundonte gjithkund në zonën e Adriatikut dhe Mesdhe sigurisht që nuk ishte aspak i vetëkuptueshëm.³⁰

5. Realiteti shqiptar në Kolegjin Ilirik të Loretos

Siç vumë oroe qysh në paragrafët e parë të këtij punimi, numri më i madh ankesave në letërsinë e derisotme dokumentare-shkencore precipiton sidomos në shtresën e poshtme përgjatë boshtit kronologjik, që vjen me thënë bash në fillesat e aktivitetit të këtij kolegji, por që ngërthejnë në vazhdimësi thuajse gjithë fazën e parë të gjallesës së tij: I. a) 1580 – 1593 në Loreto (§ 2.1) dhe b) 1593 – 1624 në Romë (§ 2.2). Mungesa të theksuara në regjistra vjetorë, por edhe ato të dhëna të paka biografike mbi rishtarët ilirikë në dokumentacionin arkivor ekzistues – sado i rrallë dhe rastësor qoftë – bëjnë të përsiatet dhe mëtohet gjithherë vetëm me hamendje si numri i tyre i përgjithshëm, ashtu edhe përkatësia etnike-gjuhësore e secilit syresh (§ 2vv.).

Asgjëmangut, denduria më e madhe e pranisë së rishtarëve shqiptarë, përkatësisht prej atyre dioqezave me shumicë relative të popullsisë katolike shqipfolëse, pritet të rritet sidomos në fazën e dytë: II. 1624 – 1798 kur fiksohen në bulën e Papë Urban-it VIII (1627) edhe vende të posaçme për këto dioqeza: *citra et ultra Drinum*. (§ 2.3) Për më tepër në këtë fazë edhe dokumentacioni arkivor shtohet dukshëm e bashkë me të edhe të dhënat biografike i kemi në rritje, çka na lejon të deduktojmë me pak a shumë siguri, krahas përkatësisë etnike-gjuhësore të njërit ose tjetrit rishtar edhe mbarëvajtjes në studime të secilit syresh.

Mungesa deri diku të konsiderueshme rifillojnë të shfaqen në fazën e tretë të jetës së kolegjit: III. 1834 – 1860, e cila gjithsesi dallon prej së ashtuquajturës periudhë klasike, pra fazës II., pasi vetë kolegji ndryshon sigurisht jo thjesht dhe vetëm emërtimin: *Collegium Illyricum-Picenum* (§ 2.4), por edhe strukturën e sidomos programin mësimor të formimit fetar-intelektual. Pas gjase, janë këto dy arsye të forta, të cilat kanë nxitur deri sot studiuesit në shumësinë e vet t'i anashkalojnë trajtimin të kësaj faze, duke mëtuar ndoshta me të drejtë, se kemi të bëjmë në këtë rast me të tjera rrethana historike-kulturore, të cilat parakuptojnë një hetim të mëvetësishëm.³¹

Le të ndalemi në vazhdim në secilën fazë në veçanti, duke i vështruar këto thjesht dhe vetëm nga perspektiva e pranisë së elementit etnik shqipfolës ndër rishtarët e kolegjit në kohë e hapësirë. Sigurisht që për arsye objektive dhe subjektive në shumë raste, sidomos gjatë hetimit të

30 Përshkrim i hollësishëm i rrethanave historike-sociale të kësaj periudhe dhe zhvillimet negative që përjetoi jeta në kolegji sidomos te Kovačić 2003 235vv.

31 Kovačić 2003 239v.

fazës së parë të aktivitetit të këtij kolegji (1580 – 1624), jemi mjaftuar t'i përcjellim lexuesit sqimatar vetëm konsiderata të përgjithshme.

5.1. Faza I: vitet 1580 - 1624

Faza e parë e aktivitetit të kolegjit karakterizohet, siç përmendëm më lart, nga zbrazësi të theksuara të dokumentacionit arkivor, sidomos sa i përket regjistrave të rregullt, të cilët mungojnë plotësisht për vitet mësimorë 1584-1593. Gjithsesi, në rast se mbajmë parasysh rrjedhat e zhvillimit, përkatësisht arsyet e themelimit dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të këtij kolegji, na duhet të paqtohemi disi me përsiatje të tilla, që për elementin shqiptar rrethanat nuk ishin aspak fatlume, mbasi në këtë fazë edhe orientimi ka qenë i tillë që të pranoheshin në kolegji (vetëm ose kryesisht) rishtarë dalmatinë e për rrjedhojë edhe syresh ilirikë, pra romanisht- dhe sllavishtfolës. Caku gjeografik më jugor i pranimit fillonte me Raguzën (= Dubrovniku i sotëm), duke u ngjitur gjithnjë e më lart drejt Veriut të Gadishullit Ballkanik. Këtë situatë e qartësojnë disi edhe ato pak lista që kemi arritur të gjurmojmë dhe qëmtojmë lidhur me aktivitetin e Kolegjit në Loreto në vitet 1581 - 1584, ku në rastin më fatlum krahas emrit të rishtarit shënohet edhe dioqeza, përkatësisht qyteti dalmat që hynte dorëzanë për të dërguar nxënësit në kolegji.³²

Sa i përket periudhës romane të aktivitetit të Kolegjit, një punë deri diku shteruese kanë bërë Jurić dhe Korade (1932; 1982, 1983), të cilët përcjellin të parët rezultate konkrete hetimi të analeve të Seminarit Roman në Romë përgjatë viteve 1693-1697/8³³ e ku përpos emrit dhe trevave të origjinës shënohet edhe koha e hyrjes në kolegji të njërit apo tjetrit rishtar. Në këto lista feks në lupën tonë të vëzhgimit vetëm një emër, shi <Damiano Albanesi> nga <Gionama>, i regjistruar në seminar si rishtar ilirik më 20 shtator 1596. Kërkimet tona arkivore në këto anale³⁴ nuk kanë dhënë aspak rezultatin e dëshiruar lidhur me izolimin gjeografik të top. <Gionama> në hartën e Ballkanit. Ndërkohë që ky rishtar bashkë me emrin e vendit nga vjen na shfaqet edhe dy herë të tjera në këto anale, khs.:

- a) <Gionama | Damiano Albanesi> (Nappi 223: Anno MDLXCVI = 1596 Fondo 32)

32 Materiali dokumentar në ASSC është ezauruar nga JURIĆ 1932. Shih për këtë JURIĆ & KORADE 1983 63-4.

33 JURIĆ & KORADE 1983 65vv: "Nomi delli schiavoni Venuti da Loreto al Seminario Romano dell anno 1593"

34 Bëhet fjalë për referimin e një materiali në dorëshkrim me autor G. NAPPI-n: Annali del Seminario Romano II, i depozituar në arkivin e Universitë Pontificia Gregoriana në Romë (Sign. 2800-2801). Shkruesi i këtyre radhëve dëshiron t'u shprehë këtu falënderimet e rastit kolegëve Ardian Ndreca dhe Blerina Suta, të cilët mundën t'i sigurojnë skanime pjesësh të tëra të këtij materiali.

- b) <E Schiauoni furono: Michel Cetilla da Cataro [...] Damiano Albanesi da Gionama fù riceuto dal Card[inale] di Camerino Protett[or]e [...]> (Nappi 234b: Anno MDLXCVI = 1596 Fondo 32, f. 43).

Pa dashur të vëmë aspak në dyshim origjinën shqiptare (qoftë edhe zanafillëse) të këtij rishtari, mund të aludojmë vetëm me hamendje për fshatin e sotëm *Gjonmi*³⁵ në Shqipërinë e Veriut si vendlindje e tij e mundshme; sigurisht pa dashur assesi të vëmë dorën në zjarr për këtë, d.m.th. nuk duam të përjashtojmë aspak alternativa të tjera zgjidhjeje që mund t'i japin dum dikur kësaj enigme.

Edhe më problematike na paraqitet periudha e shpërnguljes së kolegjit për më shumë se 25 vjet në ambientet e *Collegio Clementino* në Romë (1698 – 1724: shih § 2.2.), që drejtohej prej etërve somaskitë. Për gjithë këtë periudhë është gjetur në një rast të vetëm një folje e veçuar e larg çdo lloj konteksti dokumentar-historik dhe që duket t'i takojë vitit 1618.³⁶ Në të lexojmë një tubë emrash rishtarësh ilirikë, të regjistruar atë vit; por vetëm kaq, d.m.th. pa asnjë të dhënë shtesë, madje as sa i përket dioqezave nga vinin. Edhe në këtë listë feks në sytë tanë një emër, pas gjase tejet domethënës, bash i pari në listë: <Marco Albanesi>. Ç'është ky *albanes* e ç'punë ka ky të na përzihet me *ilirët e rinj*, që vjen me thënë ç'lidhje na paska ky pinjoll i Kolegjit Ilirik të Loretos me bashkësinë katolike shqipfolëse këtë periudhë? Pyetje mbi pyetje: megjithatë na duhet të pranojmë se në përjasje me rastin e mësipërm, bash me Damiano Albanesi-n nga <Gionama>, në këtë rast të dytë jo vetëm që jemi të pasigurt, por e kemi thjesht të pamundur të hamendësojmë vendlindjen, përkatësisht dioqezën nga vinte ky rishtar.

Mundësitë e lajthitjes së gjykimit shkencor në këtë mjedis historik-dokumentar amorf rriten dukshëm. Mjafton të mbajmë parasysh këtu emigracionin e fuqishëm shqiptar gjatë shek. XV-XVII, pas gjase edhe në veri e sidomos përgjatë bregdetit dalmatin, ku përballemi me përzjerje të forta etnike-gjuhësore, sidomos në qytetet-porte e qendrat urbane.³⁷ Kështu p.sh., lejohemi të përcjellim në debat me siguri absolute emrin e rishtarit të mëvonshëm <Baldo Albanasso> vs. <Baldassar Albanasio> nga Zara (= sr./kr. *Zadar*), i cili na qenka dorëzuar edhe ky në kolegji, shi më 14 korrik 1641 (§ 6.2.1 nr.***, shën. 75). Mbiemri i tij cyt të njëjtin problem: josh çdo sy e pendë studiuesi albanolog që të hyjë në mëkat ose të pranojë me mirakandje një të tillë, duke përsiatuar këtu menjëherë prejardhjen

35 CORDIGNANO (1934 67) regjistron forma të ndryshme të këtij toponimi në dokumentacionin mesjetar, si p.sh.: <Gionami>, <Gionemi>, <Gionimi>.

36 JURIĆ & KORADE 1983 70v, ku përcjellin si burim arkivor: ASPF SC Visitationes Colleg. et diversorum Monester. et Dioces. 1627. 5.ff., 378r, 379v. 380v.

37 Për lëvizjet migratore sllave dhe shqiptare në Italinë Qendrore në shek. XIV - XVI, shih ndër të tjerë ANSELM 1988, SANTARELLI 2000.

etnike-gjuhësore shqiptare të familjes <Albanasio> (= shq. /Arbanasi/ ~ /Arbëneshi/ ?) të Zarës, edhe pse kemi të bëjmë pikërisht me një periudhë që u paraprin në kohë me thujt 80 vjet valëve të ngulimit arbënesh në rrethinat e Zarës (: it. *Borgo Erizzo*) në gjysmën e parë të shek. XVIII.³⁸

Capitolo dello stabilimento fatto per mantenere
il Collegio Missionario di Loreto.
del mese di Ottobre 1880.

Prima che questo seminario sia in numero di quaranta sei persone, cioè sedici tridenti,
Prefetti di camera quattro, due servitori, et quattro della compagnia di S. Maria per il
governo di tutti.
In questo la 1.^a casa sia tenuta dove et consegnare sempre per sostituirsi per officio
lecturari, per libraria, per cantina, et per gli altri uffici, et bisogni di detto seminario,
come già in gran parte gli è stato dato, et consegnato.
Di più consegnarsi la prima metà di tutti i mesi, malfermi, et poveri conformi alla
lista, che se n'è data et in parte eseguita.
Di più sia tenuta per il vitto di tutti degli il pane della qualità che si mangia nel
Refettorio del R. capitolo nella misura seguente, cioè dal primo d'Aprile per fino
al primo d'Ottobre borse due per borse al giorno. Dal primo d'Ottobre per fino al 1.^o
di Marzo borse due, et once quattro da pigliarsi giornalmente alla dispensa di detta
sancta casa.
Di più consegnarsi se, cioè 372, di farina netta l'anno per uso della cucina et per
altri loro bisogni.
Di più come sei di vino puro per borse all'anno, i da consegnargli al tempo della muta
acciaio lo borsare intitolare nella cantina sua nella corte, che sarà in questa casa sarà
tenuta dagli, i da pigliarsi giornalmente dalla cantina di 1.^a casa a borse, i come meglio
li tornasse.
Di più quattro borse d'aceto ogni anno.
Di più una borse di carne per borse ogni giorno che se ne mangiarà la pigliarsi i alla
dispensa di la S. M. et taglia, i dal Macello, ovvero come meglio li tornasse salando
colli compatibili di 1.^a casa il conto della carne, che sarà preso di mese in mese.
Di più borse sedici di S. Maria ogni settimana, che si mangiarà di grasso.
Di più mesi cinquanta d'oglio netto di quello che mangia il R. capitolo.
Di più per il compensato de giorni d'ingrasso d'ollagioni due per borse ogni giorno.
Di più borse quattrecento di carne porcina fresca al tempo di salata, cioè nel mese di Luglio.
Di più borse sedicente cinquanta di formaggio all'anno stagionato, i pesi solo uovano.
Di più una borse di legumi di diuole tutti ogni anno.
Di più mesi, et per l'anno di tale parte d'ovino, parte nero.
Di più fidi et ove tre volte alla settimana dal primo d'Ottobre per fino del fine d'Ottobre

116

Faksimile 2: Informacion mbi shpenzimet mujore të kolegjit
(Burimi: ARSI)

38 Hollësisht KOVAČEC 2002 67vv.

Së fundi, lejohemi të shtojmë si alternativa zgjidhjeje që premtojnë sukses, por që shkruesi i këtyre radhëve nuk kishte si t'i ndërmerre në mënyrë ballore në këtë studim qoftë edhe për arsye kohe, sikurse edhe sosh organizative e financiare, andaj dëshiron me këtë rast vetëm t'i referohet kësaj mundësie si kriter pune metodike. Prashtu:

- a) mungesa e dokumentacionit të mirëfilltë arkivor përgjatë gjithë kësaj faze të parë mund të plotësohet në parim me të dhëna anësore që i fitojmë qoftë nëpërmjet relacionesh e letrash, të botuara ose jo deri sot, por që lidhen pandërmjetshëm me aktivitetin e klerit katolik në hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan;
- b) Një tjetër burim kërkimi intensiv mundësojnë edhe manualët ekleziastikë të natyrës enciklopedike,³⁹ të cilët përcjellin të dhëna biografike shtesë të paktën për klerikë të karrierës kishtarë.

Që si njëra ashtu edhe tjetra perspektivë kërkimi nuk rrjedhin gjithmonë si në vaj, përkatësisht provokojnë në shumësinë e rasteve “fitore” si ato të Pirros, këtë jemi në gjendje ta shembëllzojmë tash me tri-katër raste që kemi arritur t'i qëmtojmë gjatë leximit të bl. VII të veprës madhore *Illyricum Sacrum* (Farlati & Coleti 1817), si edhe në një relacion të vizitës apostolike të Imz. Marino Bizzi-t në Shqipëri (1610), të cilat po i trajtojmë thukët në vazhdim.

5.1.1. Çështja “Ermanji” (= <Ducas Armanus> – para vitit 1590)

<Ducas Armanis> është emri më i hershëm në aksin kronologjik të hetimeve tona lidhur me rishtarët e Kolegjit Ilirik të Loretos që vinin nga Provinca Kishtarë e Arbënit. Ky emër na shfaqet jo rastësisht në bleun VII të veprës “*Illyricum sacrum*” (Farlati & Coleti 1817, 324), ku në rubrikën e gjatë “*Episcopi Scodrensis*” (f. 308vv.) mësojmë që ipeshkvi i 30-të i radhës të jetë konsakruar më 15. korrik 1590 <Ducas> (= /Duka/), i cili i shërbeu ipeshkëvisë si i tillë për thujse 30 vjet. Ky pinjoll i familjes fisnike i shkodrane <Armani> (= /Ermanji/, shq. sotme /Ermaji/ edhe si lagje katolike në Shkodër) shërbente më parë meshtar në po atë qytet, pasi kishte ndjekur më parë studimet në Loreto. Kështu, ndër të tjera mësojmë në këtë vepër:

<Ducas Episc[opus] Scodrensis XXX | Scodrae nobili genere ortus, cognomento Armanus, alumnus Collegii Illyrici Lauretani, Presbyter Scodrensis, & Parochi munere egregie functus; de quo Card. Santorius 15. Julii an. 1590. itemque de statu Ecclesiae Scodrensis haec retulit in Cardinalium Consilio.> (VII 324)

Duke e marrë këtë kumt si të mirëqenë lejohemi të mëtojmë tash pa mëdyshje të rastit që rishtari i shkodran <Ducas Armanus> ka vizituar Kolegjin Ilirik të Loretos, duke i mbyllur studimet në Loreto para vitit 1590.

39 FARLATI & COLETI 1817 VII 284; Eubel IV 1935 305.

5.1.2. Çështja “Budi” (= <Peter Budi> 1566 - 1621)

“Presbyter Albanensis, cui Budio aut Bulio cognomen, ut in suis schedis animadvertit Card. Garampius, & constat ex monumentis Collegii Illyrici Lauretani, ubi fuerat educatus. [...]” (Farlati & Coleti VII 1817 284)

Është kjo fjalia e parë e zërit enciklopedik që na kumton diçka edhe lidhur me formimin fetar-intelektual të Pjetër Budit, të cilin do ta konsideronim si të mirëqenë, sikur vetë ai të mos tëharrte më shumë me pendën e tij, duke mëtuar të kundërtën, meqë formimin e vet klerikal-intelektual, madje edhe gjuhët e letrave (latine e italishte) ky pinjoll i kulturës së hershme të shkrimit shqip ngulmon t’ua ketë “vjedhur” tinëz e pak nga pak në të ri të vet ipeshkvijve që u shkonte pas. Ani, këtë punë Budi ynë nuk ia kallëzon do-kujt-do në rrugë, por ia rrëfen zyrtarisht në letër Kardinalit Gozzadino dora vetë, të cilit i shkruan më 15 shtator 1621, ndër të tjera, se:

“[...] da gioventù mia mi son trattenuto quasi sempre in servizio di alcuni Vescovi del nostro paese, appresso li quali ho essercitato il studio di queste poche lettere insino all’ età di 21 anni, che allora fui fatto sacerdote [...]”⁴⁰

Por jo vetëm kaq (!), sepse në pasthënien e “Pasëqyrës së t’ rrëfyemit” (Romë 1621) Budi rrëfëhet hapur madje me një ton që mbërrin caqet e sarkazmës:

“Posikundrëse sã tjerë shokëtë e tu, ende u me ta, që Zotōnë mã di se shkollënë e kolegjenë veçëse nda kam pãm n cë lerg ò gjegjunë emënitë, ndish asndonjë fjalë të vetëmenë ndër to xanë s’e kam, as gjegjunë, mã gjã p’r ata s’mun’ i pronem fajt [...] tue pasunë gjithëherë gjegjunë, e pam, e xanë, e pyetunë ndaj sã upeshkëpinj, e fratënë [...]” (tejshkrim i R. Ismajlit)⁴¹

Asgjëmangut, ballafaqimi i këtyre dy dëshmimeve të dorës së parë me atë kumt enciklopedik që e regjistrojnë Farlati & Coleti përcjell në shqisat dhe gjykimin tonë vetëm konfuzion, sepse jo vetëm që nuk na bën zemra, por s’kemi aspak arsye me vënë në dyshim atë çka na ka lënë trashëgim gjaku ynë i paprishur. Ndërkohë që nuk e kemi të lehtë të hedhim poshtë patjetër kumtin e klerit enciklopedist të kohës, anipse edhe ky në ndonjë rast ka shkëlur në dërrasë të kalbur, duke i bërë punët vetë lëmsh e çorap.⁴² Fakt

40 Shih ZAMPUTI (bot.) 1963 I 296: „[...] në rininë time kam qëndrue pothuaj vazhdimisht në shërbim të disa ipeshkvijve të vendit tonë, pranë të cilëve jam marrë me studimin e këtyre pak ditunive deri në moshën 21 vjeçare, sepse aso kohe qeshë bamë meshtar [...]”

41 Shih ISMAJLI (bot.) 2006 14.

42 Probleme të kësaj natyre na kanë dalë p.sh. gjatë hetimit të karrierës klerikale të Imz. Gjergj Radovanit, të dhënat e të cilit te Farlati & Coleti (VII 334: Georgius II Episc. Scodrensis XLIL) janë ngatërruar pa dashje me ato të sivëllait të vet Imz. Gjergj Junkit, i cili bariste atëbotë në Ipeshkëvinë e Pultit.

është që e vërteta kërkon fakte e janë pikërisht këto fakte që faktikisht nuk i disponojmë. Andaj s'na mbetet gjë tjetër, veçse të (ri)interpretojmë ato ekzistuese, duke i shembëllzuar me sosh shtesë:

Prashtu, po të nisemi tash nga data, në mos të paktën moti, i shugurimit të Budit 21-vjeçar bash më 1587,⁴³ studimi i tij i mundshëm në Kolegj rrudhet shi në periudhën e parë të fazës po të parë, bash kur kolegji gjëllinte në Loreto (1580 – 1593) e pikërisht për këtë periudhë kemi të dhëna sporadike vetëm për vitet 1581 – 1584 (shih më lart). Parë nga kjo perspektivë kërkimi i mëtejshëm mund e duhet të përqendrohet pikërisht në vitet 1585 – 1587, të cilët përmbushnin në fakt edhe kohën e parashikuar të formimit të një rishtari në kolegj për atë periudhë (§ 2.1.). Por përderisa Budi vetë këmbëngul që “kolegjinë veçëse nda kam pām n cë lerg”, kjo ka bërë që shumë studiues historianë e filologë – qoftë edhe me një dozë të theksuar dashamirësie (!) – nuk mungojnë assesi të përsiasin edhe mundësinë e studimit për njëfarë kohe në atë kolegj, por pa përjetuar pranë Shtëpisë së Shenjtë në Loreto vetëm shugurimin fatlum të priftit, të cilin do ta ketë gëzuar me siguri në dioqezën amë. (Ismajli 2006 14)

Pa synuar aspak të prishim gjakrat e studiuesve dhe kolegëve tanë, lejohe mi gjithsesi ta relativizojmë, përkatësisht ta zgjerojmë radiusin e kësaj përsiatjeje në formë hamendjeje, duke përcjellë në debat – e pse jo!!! – edhe mundësinë e largimit me ose pa dashje, madje deri në përzënie të Budit nga ai kolegj. Parë nga kjo perspektivë, Budi gjan me kumtet e tij të ketë nxjerrë vetëm dufin ndaj atij kolegji, të cilit ndoshta edhe nuk ia kishte parë hairin. Po, po! Nuk duhet të bëjmë aspak çudi për raste të kësaj natyre, edhe pse nuk kemi fakte konkrete. Por arsyet janë të thjeshta, thuajse triviale:

- Që rishtarë të tillë po-shqiptarë, të përzënë me bujë e bori bash nga ky kolegj, por që ditën me dëshirë e vullnet të mirë të ngjisin shkallët e karrierës klerikale në dhe të vet, duke u ulur madje edhe në fronin e arqipeshkvit, nuk janë të rralla. Sosh kemi mundur t'i verifikojmë falë hetimeve tona në fazën e dytë të jetës në po këtë kolegj me Nikollë Kurbinin, i cili u dëbua më 25 gusht 1647 nga kolegji për sjellje të pahijshme, por erdhi e u shugurua në dioqezë të vet, duke mundur të ngjisë pas dhjetë vjetësh edhe katedrën e arqipeshkvit të Durrësit. (§ 6.2.1., nr. 24)
- Që këta tipa tokësorë bëjnë çudi edhe në punë letrash e librash, këtë na e mëson më mirë se kushdo sivëllai i tij, Pjetër Bogdani dora vetë si “mâ i vlerti ndër shkrimtarët e hershëm të shqipes” (Rrota 1941 46), i cili fillon në fakt studimet në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë (13 shtator 1642), i vazhdon ato në Kolegjin Ilirik të Loretos

43 Ky vit mëtohet sot gjithkund në letërsinë shkencore albanologjike; shih së fundi ISMAJLI 2006 14.

(20 mars 1648) dhe pasi u shugurua prift, pas gjase po në Loreto, rikthehet shkurt në Romë për të marrë trofenë e fundit që i kish mbetur: diplomën e Doktorit në Filozofi dhe Teologji. Veçse ndryshe nga Pjetër Budi, këto ecejake të Pjetrit tonë të Dytë shkruesi i këtyre radhëve ka mundur t'i izolojë gjatë hulumtimeve të tij në arkivat e Kolegjit Urban në Romë dhe të Kolegjit Ilirik në Loreto, ku mëson se si ai na paska bërë vetë edhe kërkesë me shkrim e me firmë për t'u larguar nga sytë këmbët prej atij kolegji e të kthehej njëherë e mirë në dhe të vet, thjesht dhe vetëm se rektori i kolegjit i kishte ardhur pas gjase në majë të hundës. Që ky rishtar “kryeneç” nuk u dënua bash ashtu siç pritej, d.m.th. sipas rregullave e urdhëresave të kohës: me izolim dhe dëbim, por thjesht u transferua në Kolegjin Ilirik të Loretos për të çuar deri në fund formimin e vet fetar-intelektual, kjo ka të bëjë, pas gjithë gjasash, thjesht dhe vetëm me dhuntitë e pazakonshme të intelektit të tij. Duke ecur pikërisht në këtë hulli, lejohemi tash të mirëkuptojmë edhe atë “hakmarrje” të “mâ të vllertit” në historinë e kulturës shqiptare, rikthimin e tij sado të shkurtër në Romë në maj 1651, për të mbrojtur e ngadhënjyer bash në Kolegjin Urban diplomën e Doktorit në Filozofi dhe Teologji.⁴⁴

5.1.3. Çështja “Gjec Bardhi” (= <Georgius Blanchus> 1577 – 1647)

“Gizzius aut etiam *Grillus* dictus [...] Natus est Sappae ex familia Blanca, Filius Fratris Nicolai Episcopi Sardensis & Sappatensis, de quo supra, in Collegio Illyrico Lauretano educatus. [...]”:

Këtë kumt e mësojmë në njërin ndër tre zërat, që kanë parashikuar për Imz. Gjergj Bardhin – axha i Frangut tonë të Bardhë (= <Franciscus Blanchus> = *Frang Bardhi*⁴⁵) – Farlati & Coleti në kryeveprën e vet (VII 1817 284v.; krahas 126, 288). Pa dashur të ndalemi gjatë këtu për këtë personalitet në jetën dhe historinë ekleziastike shqiptare që – siç edhe pritet!!! – i mungon me zë të veçantë Fjalorit fatkeq Enciklopedik Shqiptar (Tiranë 1985; I-III Tiranë 2008/9), na mjafton të përqendrohemi tani në informacionin mbi formimin e tij në Kolegjin Ilirik të Loretos, një e dhënë kjo që i shkon përshtat edhe tematikës së këtij shkrimi.

I pari e ndoshta edhe i fundit studiues filolog që e kumton këtë informacion është murgu francez Mario Roques në parathënien që i bën botimit të fjalorit të Frang Bardhit, nipit të Gjec/Gjergj Bardhit. Por më shumë se kaq nuk mësojmë dot gjë as prej tij. Andaj kemi të bëjmë

44 DEMIRAJ: Grimca biografike për shkrimtarët tanë të vjetër: III Pjetër Bogdani, në “Hylli i Dritës” 2 [2016] (në shtyp).

45 *Frangu i Bardhë* është shqipërim i formës së latinizuar: <Franciscus Blanchus> që e ndërmerr vetë autori në fund të parathënies së fjalorit të tij latinisht shqip (Romë 1635). Shih DEMIRAJ 2008 85.

në rastin tonë rishtas me një çështje të dyzuar që lejohemi ta zgjidhim vetëm me rrugë kausale, në kuptimin që: po të dimë vendin mësojmë të paktën me afërsi edhe kohën, kur ka studiuar ose e kundërta. Insistojmë në këtë procedurë metodike, duke cilësuar qysh në fillim si jodomethënës përcaktorin “Lauretanum” që e citojnë në fakt vetë Farlati & Coleti, meqë bashkësia e rishtarëve ilirikë vijonte të ruante atë emërtim edhe kur ky kolegji u shpërngul në Romë.

Asgjëmangut, ato të dhëna sado të paplota që kemi në dispozicion për fazën e parë të gjallesës së kolegjit në Loreto na ndihmojnë të rrëzojmë shpejt mundësinë e studimit të tij në Loreto. Mjafton të mbajmë këtu parasysh që vitin kur u hap kolegji (1580) e për rrjedhojë Gjeci ynë duhej të ishte një cullak jo më shumë se 3 vjeç, ndërsa kur ky kolegji u bart në Romë, ai sapo duhej të kishte mbushur të 16-at, një moshë kjo ende e re me hedhur letrat si kandidat për rishtar në këtë fazë të parë të kolegjit (§ 2.-2.1./2.). I guximshëm do të ishte edhe mendimi se mos kushedi ai paska nisur të studiojë në Loreto dikur aty nga faza e dytë, d.m.th. pas vitit 1624, kur Gjergj Bardhit pas gjase i kishin dalë ndërkohë thinjat, sepse i binte të kishte qenë atë mot as më shumë e as më pak por plot 47 vjeç.

Pyetje të tjera gjithsesi nuk reshtin edhe pas këtyre hamendësimeve, përkundrazi vetëm shtohen, p.sh.: Po në Romë, kur dhe ku studioi Gjeci ynë? Në Seminarin Roman (1593 – 1597) apo në Kolegjin Klementin (1598 – 1623)? Sigurisht që vitet e moshës (midis 16 deri 20) e lëkundin disi mundësinë e formimit të tij në Seminarin Roman në Romë, edhe pse s’kemi aspak të drejtë ta përjashtojmë këtë alternativë patjetër. Këtë përjashtim lejohemi tash ta përsiasim me siguri deri diku absolute, vetëm falë një kumti tjetër biografik që e fitojmë rastësisht në një relacion të Arqipeshkvit të dikurshëm të Tivarit, Imz. Marino Bizzi-t, i cili në vitin 1610 bëri një vizitë apostolike në Provincën Kishtare të Arbënit dhe, kur përshkon zonën e Zadrimes, shënon ndër të tjera:

“E passarono puochi giorni, che trouandomi io pur nella Zadrina nella villa di Crucca, doue seruiua D. Giorgio Bianchi, alunno del Collegio Clementino, Vicario e nepote del Vescovo nella chiesa di S. Demetrio restaurata [...]” (Bizzi 1610 93)⁴⁶

Përballemi kështu me një kolizion të një natyre tjetër në khs. me atë të trajtuar më lart (§ 5.1.2), i cili ka të bëjë tash me emërtimin e institucioneve: *Collegium Illyricum Lauretanum* (Farlati & Coleti) vs. *Collegio Clementino* (Bizzi 1610). Nëse duam të vjelim diçka pozitive prej këtij konfuzioni, është pikërisht përsiatja jonë, qoftë edhe pa forcë argumenti faktik, që Gjergj Bardhi duhet të ketë studiuar në Kolegjin Klementin, por me statusin e

46 ZAMPUTI 1963 123: „Kaluen pak ditë dhe, kur unë po gjendesha prap në Zadrinë, në katundin e Grykës, ku shërbente D. Gjergj Bardhi, nxanës i Kolegjit Klementin, vikar dhe nip i ipeshkvit në kishën e Shën Dhimitrit të meremetueme [...]”

rishtarit ilirik (të Loretos) dhe sigurisht përpara vitit 1610, kur Marino Bizzi kreu vizitën apostolike në Provincën Kishtare të Arbënit, përkatësisht hodhi në letër të bardhë relacionin e kësaj vizite.

5.1.4. Çështje të tjera pezull

A janë Gjec Bardhi dhe Pjetër Budi të parët dhe të fundit rishtarë shqiptarë të Kolegjit Ilirik të Loretos, që mund të kenë studiuar si të tillë pas gjase në Romë qoftë në Seminarin Roman apo në Kolegjin Klementin. Këtë çështje jemi të detyruar ta lemë hëpërhë hapur për mungesë materiali dokumentar-arkivor, përkatësisht për mungesë thujtash të plotë të studimeve mbi aktivitetin e Kolegjit Klementin në Romë, ku mund të kenë studiuar ndoshta shumë më shumë nxënës shqiptarë, që vinin nga Provinca Kishtare e Arbënisë dhe Arqipeshkëvia e Tivarit dhe e Shkupit. Mjaft domethënës është në këtë rast një tjetër kumt që kemi mundur të qëmtojmë midis rreshtash prej relacionit të Marino Bizzi-t, kur shkruan lidhur me rreziqet e sidomos me vështirësitë e komunikimit gjuhësor gjatë vizitës së tij apostolike më 1610, ndër të tjera:

“[...] e per lo più i preti, i quali hanno la cura spirituale dei popoli, non havendo dove imparare le lettere, e non posedendo altra lingua, che la materna, fuori di tre o 4 alunni del Collegio Clementino, non hanno informazione nessuna dei sacramenti, nè delle cose sacre [...]” (Bizzi 1610 139)⁴⁷

Cilët janë këta tre ose katër nxënës të formuar dikur në Kolegjin Klementin në Romë e sa mund të kenë të bëjnë ata me të ashtuquajturin Kolegj Ilirik të Loretos në këtë periudhë? Gjatë leximit të aspak të lehtë të këtij relacioni, arritëm të paktën të identifikojmë ndonjë syresh, duke u përqendruar në kërkimin tonë pikërisht në rastet kur dilte në tekstin e rrjedhshëm emri i Kolegjit Klementin, sa vijon:

- “Qui feci cominciar à sermonegiar in quella lingua [= albanese – B.D.] à D. Pietro Isij Abbate di s. Paolo alunno del Collegio Clementino, e ch’era venuto ad accompagnare per quelle parti [...]” (Bizzi 1610 83)⁴⁸
- “E dalle parti di Cavo de Lacchi mi era venuto a trovar D. Andrea Lopez, Vicario di Durazzo, e di quei contorni, il qual mi parve sacerdote di molto garboe di buaona intelligenza, essendo stato alunno del Collegio Clementino in Roma, [...]” (Bizzi 1610 109)⁴⁹

47 Shih ZAMPUTI 1963 140: “[...] Dhe ma të shumtën priftnit, të cilët kanë kujdesin shpirtnor të popujve, me që nuk kanë ku t’i marrin ditunitë dhe mbasi nuk njohin gjuhë tjetër veçse atë të nanës, me përjashtim të 3 ose 4 nxanësve të Kolegjit Klementin, nuk kanë asnjë njohuni për sakramentet as për sendet e shenjta, vetëm [...]”

48 ZAMPUTI 1963 107: “Këtu bana që të flonte me predikue n’atë gjuhë D. Pjetër Izi, abat i Shën palit, nxanës i Kolegjës Klementine, i cili kish ardhë për të më përciellë nëpër ato anë [...]”.

49 ZAMPUTI 1963 149: „Dhe nga anët e kepit të Turrës, kishte ardhë me u pjekë me mue D.

- “[...] che la Zadrina è assai meglio governata che l’altre parti d’ Albania per la continua residenza e vigilanza del Vescouo zappatense con doi alunni del Collegio Clementino [...]” (Bizzi 1610 140)⁵⁰

Po të mbajmë parasysh këto raste, kur na del në tekst Kolegji Klementin, përkatësisht rishtarë shqiptarë që kishin studiuar pak kohë më parë në të, arrijmë të identifikojmë, krahas Gjergj/Gjec Bardhit, edhe emrat e dy rishtarëve të tjerë me origjinë pas gjase shqiptare, të cilët kishin studiuar ndërkohë (para 1610) në Kolegjin Klementin. Këta janë <Andrea Lopez> (= *Ndre Lopësi*) dhe abati <Pietro Isij> (= Pjetër Izi).

Ndonjë rast tjetër sporadik që kemi mundur të qëmtojmë në fund të kësaj faze, siç është p.sh. <Giorgio Neri> nga Kruja (§ 6.2.1. nr. 8), i cili ishte nxënës i Kolegjit Klementin në Romë dhe u bart atëbotë pa një e pa dy drejt Loretos bashkë me rishtarë të tjerë për të mbyllur studimet aty, në Kolegjin Ilirik të rihapur, këtë rast e kemi parë të arsyeshme ta përfshijmë në listën e rishtarëve shqiptarë që i takojnë fazës së dytë të aktivitetit të këtij kolegji (1624-1798).

Në mbyllje të këtyre vëzhgimeve paraprake për këtë fazë të parë të aktivitetit të Kolegjit Ilirik të Loretos, lejohe mi të përmbledhim thukët se prania e elementit shqiptar në këtë kolegji nuk do përjashtuar aspak si e tillë, veçse mungesat e materialit dokumentar nuk mundësojnë ndërmarrjen e një pune ballore, ndërkohë që induktime me siguri relative kufizohen në thuajse në pesë-gjashtë raste: Dukë Ermanji, <Damiano Albanesi>, Pjetër Budi, Gjergj Bardhi, Ndre Lopësi dhe Pjetër Izi.

Parë nga perspektiva albanologjike e studimit, vështirësi të kësaj natyre na nxisin gjithsesi të mbajmë gjithherë sy e veshë hapur në hulumtime të ardhshme mbi këtë kolegji sidomos gjatë periudhës së tij klementine (Romë: 1598 – 1623). Që qëndrimi refraktar ndaj elementit joilirik, domethënë pranimi (edhe) i atij shqiptar në kolegji, mund ase duhet të ketë ndryshuar disi drejt kahut pozitiv, sidomos pas vitit 1584, këtë e nxjerr në pah krahas qerthullit problematik të trajtuar më lart (§ 5.1.1: “Çështja Ermanji”; §5.1.2: “Çështja Budi ...” etj.), edhe një farë ndërhyrjeje, e bërë si të thuash nga lart, bash kur vetë rektori i parë i këtij kolegji, Tommaso Ragio gjatë vizitës së tij po të parë (1584) në trevat e prapatokës ballkanike, mësoi jo vetëm se këto zona kishin shumë më tepër nevojë për barinj shpirtërorë, por edhe se:

“si considerò che il più sicuro modo per impadronirsi del Paese, et il più riuscibile, era il seminare gente di questo seminario per quelle terre, città et ville, dove sono Cristiani della nazione di rito

Ndre Lopësi, Vikar i Durrësit e i atyne rretheve. Ky m’u duk meshtar i njerëzishëm dhe me dije të mirë, me që kishte qenë nxanës i Kolegjit Klementin në Romë.”

50 ZAMPUTI 1963 207 „[...] sepse shihet se Zadrina asht e qeverisun shumë ma mirë se vendet e tjera të Shqipnisë, meqenëse aty qëndron vazhdimisht dhe mbikqyrë ipeshkvi i Sapës bashkë me dy nxanës të Kolegjit Klementin [...]”

latino et maxime nelle parti più dentro del Paese, et più vicine a Constantinopoli [...]”⁵¹

5.2. Faza e dytë (1624 - 1798)

Faza e dytë e aktivitetit të Kolegjit Ilirik të Loretos në Loreto, edhe pse shumë më e shtrirë në kohë, ndryshon katërcipërisht në përjasje me të parën, çka vjen me thënë vetëm për mirë; e kjo sa i përket qoftë gjendjes së burimeve dokumentare-arkivore, qoftë edhe strategjisë së hetimit dhe metodikës së punës me to. Asgjëmangut, synimi ynë mbetet i njëjti e në rastin tonë sendërtohet si hap i parë me identifikimin dhe regjistrimin mundësisht sa më të plotë të rishtarëve shqiptarë, përkatësisht të atyre që vinin në kolegji kryesisht, madje sidomos nga Provinca Kishtare e Arbënit, por edhe dikur prej Kishës Metropolitane e Ohrit, sikurse në vazhdimësi prej Arqipeshkvëvisë së Shkupit me shumicë të konsiderueshme të popullsisë katolike shqipfolëse, kryesisht në trevat perëndimore. Një hap i dytë dhe më se i domosdoshëm është pasqyrimi mundësisht sa më i saktë e tërësor i të dhënave shtesë mbi jetën dhe mbarëvajtjen e studimit të secilit syresh.

Ndër burimet kryesore që ndihmojnë në këtë drejtim janë materialet e depozituara në tre arkiva të ndryshëm, të cilët i kemi shfrytëzuar në dorë të parë:

- ARSI: Sig. Rom. 229: Liber in quo habentur Nomina Alumnorum qui in Coll’ Illyrico Lauretano praestiterunt Juramentu[m] Ab Ano D.ni MDCXXVIII & Princeps et Nomina Rettori Collegi. Këtu janë fiksuar emrat e shumë rishtarëve me datat, kur kanë bërë betimin meshtarak, së bashku me emrat e rektorëve dhe ata të dy dëshmitarëve të besë në shumësinë e rasteve. Janë të regjistruar në këtë libër emrat e rreth 500 rishtarëve ilirikë.
- ASSC: Antichi Regimi, tit 30-32 1r – 85v: *Nomi, cognomi, patria, entrata e partenza degli alunni et ordini sacri*. Bëjmë fjalë për një libër regjistrimi emrash të rishtarëve që kanë hyrë në kolegji gjatë viteve 1624-1686. Regjistrimi i çdo emri përshkohet në shumësinë e rasteve me shënime prej duarsh të ndryshme, ku janë pasqyruar në tekst të rrjedhshëm (italisht dhe latinisht) të dhënat kryesore për rreth 550 rishtarë.
- ASPF: SC Collegi vari, vol. 35 (Anni 1627-1739), 36 (Anni: 1740-1883). Në këto vëllime ndeshim kryesisht fletë regjistrash në formë tabelash ku janë përfshirë përpos emrave të nxënësve edhe të dhënat kryesore mbi moshën, dioqezën amë, ase vendlindjen (patria), kurset që ndjekin në vitin shkollor përkatës si edhe në ndonjë rast të veçuar edhe vërejtje shtesë lidhur me mbarëvajtjen në studim, shugurimin etj.

Siç mund të kuptohet edhe nga këto burime që cituam më lart bashkë

51 Hollësisht MORONI 2010 12v.

me sqarimet përkatëse, në këtë periudhë gjendemi para një situatë tejet të favorshme për punë të mirëfilltë lidhur me hetimin, mbledhjen, seleksionimin dhe sistematizimin e materialit arkivor. Probleme shfaqen vetëm në ato rase kur hasim boshllëqe në fletë-regjistrat për disa vite me radhë. Këto zbrazësi jemi rrekur t'i plotësojmë si dhe sa e kemi të mundur me të dhëna anësore të dorës së dytë (shih më lart § 5; 5.1).

Suksesi në hulumtimin e kësaj faze është i dukshëm, meqë në periudhën e dytë loretane të kolegjit prania e elementit shqiptar ishte e fiksuar edhe në bulën papnore e më pas edhe në sajë të bursave Albani e Vlladani (§ 4). Ka momente që ky element, sidomos pas vitit 1740, shtohet me shumë e më shumë rishtarë shqiptarë, që vinin nga Arqipeshkvia e Shkupit me një bursë të veçantë (*locus supranummeratus*), të cilën e financonte vetë Kongregacioni i Shenjtë i Propaganda Fide-s (§ 4) Andaj nuk ekzagjerojmë aspak, kur në korrespondencën e kolegjit vërejmë në ndonjë rast edhe varje hundësh e buzësh e ngritje toni në zërin e ndonjë rektori të kolegjit. I tillë është p.sh. rasti me rektorin Giacomo Micaglia, i cili verën e vitit 1650 mëngon të ngrejë lart bodecin për punë të elementit të shumtë shqiptar, meqë sipas tij në bulën papnore ishin parashikuar vetëm dy vende për ta, ndërkohë që: “[...] si trovavano cinque Albanesi nel Collegio, ciò è questo Martino Crisio, Pietro Bogdano, Gerardo Galata, Nicolò Vladagni e Marino Spizza” (ASPF SC Albania 1673-1676. II fol 3r.)⁵²

Rishtari i fundit dhe më i pafati në këtë fazë të historisë së kolegjit është gjithashtu një shqiptar: Pjetër Gjina prej Ipeshkëvisë së Shkodrës, i cili në fakt erdhi dhe u paraqit në kolegji, por s'arriti të gëzojë asnjë ditë arsimimi në të. E mësojmë këtë detaj në njërën ndër letrat e fundit e të dhimbshme të rektorit të fundshekullit në atë kolegji, Don Carlo Ravenali-t më 23 gusht 1797, si vijon:

“La presente è diretta a notificare all S. V. R.^{ma} l'arrivo a questo Collegio del Giovane Pietro Ginagni di Scutari venuto a rimpiazzare il Posto Vladagni e la partenza dei due Alunni, Lazzaro Vladagni che compitò il corso di suoi studi e stato ordinato Sacerdote e di Lazzaro Remani, ch'era qui per la Chiesa di Scutari e che dalla S. Cong.^{ne} Loretana è stata licenziato per mancanza di Vocazione allo stato Ecclesiastico, e non buoni di portamenti. Mi prevalgo dell'opportunita per umiliare all' E. V. R.^{ma} il profondissimo ossequio e col bacio della Sagra Corpora riprotestarmi

Di V. E. R.^{ma}

Coll.^o Ill.^o Loreto 25. Agosto 1797

Umil.^o R.^{mo} obl.^{mo} Serv.^o

D. Carlo Ravenali Rettore⁵³

52 Më hollësisht MARLEKAJ 2008² 24/shën. 39.

53 ASPF SC Collegi vari 36 831r.

Në mbyllje të këtyre vëzhgimeve mbi fazën e dytë të aktivitetit të Kolegjit Ilirik të Loretos në Loreto mund të kumtojmë tash se falë punës paraprake me materialin dokumentar-arkivor në tre arkiva të ndryshëm kemi mundur të diktojmë e regjistrojmë në një listë të përbashkët plot 106 rishtarë në shumësinë e vet, pas gjase, me origjinë shqiptare, përkatësisht syresh që erdhën e u regjistruan në kolegji nga ato treva me popullsi katolike shqiptare. Sigurisht që këtë listë nuk mund ta konsiderojmë si një cikël pune të mbyllur njëherë e përgjithmonë, sa kohë që edhe në burimet e sipërpërmendura përballemi me zbrazësi të konsiderueshme dokumentacioni arkivor.

5.3. Faza e tretë (1834 – 1860)

Faza e tretë, kur edhe kolegji ndryshon emër: Collegio Ilirico-Piceno, nuk na shfaqet aq e pëlleshme sa e mëparshmja, e kjo jo thjesht dhe vetëm falë shtrirjes së rrudhur në kohë, por edhe falë rrudhjes së numrit të rishtarëve ilirikë në jo më shumë se 12 në vit. Kjo rrudhje shkon gjithashtu në proporcion të drejtë me rrudhjen e materialit dokumentar të disponueshëm vetëm në një burim arkivor (ASPF: SC Collegi vari, vol. 36). Për fat të keq edhe këtu feksin zbrazësi jo të parëndësishme sidomos në mungesën e fletë-regjistrave në vazhdimësi kohore. Këto mungesa jemi rrekur gjithsesi t'i plotësojmë sa dhe si kemi mundur duke shfrytëzuar edhe material dokumentar të dorës së dytë, të depozituar edhe në ASSC.

Tipar pozitiv i atij materiali ekzistues në këtë periudhë është se mundëson ndjekjen nga afër të ecurisë në studim gjatë vitit arsimor përkatës për njërin ose tjetrin rishtar, meqë nuk mungojnë as vlerësimet përkatëse lidhur me aftësinë, nxënien e njërës apo tjetrës lëndë si edhe sjelljen në mësim e në jetën në kolegji të njërit apo tjetrit rishtar. (§ 6.3.)

Mbledhja dhe sistemimi i materialit të mbledhur për këtë fazë mundësoi të diktojmë dhe regjistrojmë deri në 11 rishtarë shqiptarë. Sigurisht që duhet të ritheksojmë, që ky numër – për arsye të përmendura më lart – nuk mëton aspak të jetë ezaures për të gjithë ata rishtarë shqiptarë që studiuan në kolegji në ata 26 vjet.

Nuk kemi përfshirë në hetimin tonë as financimin e katër bursave të përvitshme për rishtarë ilirikë në Kolegjin Urban të Romës, si vende studimi që i mbështeti Kapitoli i Shtëpisë së Shenjtë në Loreto gjatë viteve 1822 – 1833.⁵⁴

(vijon)

54 Shih KOVAČIĆ 2003 239. Qëmtimi i emrave të rishtarëve shqiptarë që mund të kenë përfutur nga kjo bursë i takon një studimi ballor mbi rishtarët shqiptarë në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë (1627-), të cilin e ka në dorë ndërkohë shkruesi i këtyre radhëve.

Abstract

The Illyrian College in Loreto (1580-1860) was one of those long-lived educational institutions which provided both clerical and intellectual education for Catholic clergy. Many of its priests were appointed to the Albanian Ecclesiastical Province and to the Shkup Archdiocese, thus spurring, though not directly perhaps, the cultivation of written Albanian. In the first part of the extended study, "A Cultural and Historical Survey", *Shejzat* 3-4, 2016, Prof. Demiraj centres around the circumstances which led to the foundation of this college and its teaching programmes (*Ratio Studiorum*) of the Jesuit Fathers. In fact, they ran it from 1580 to 1773. Other themes are that of everyday life in the college and further life and deeds of the Albanian seminarians.

In the second part, to be published in *Shejzat* 1-2, 2007, the author will be recounting on the life of 124 seminarians, mainly Albanians. Further bibliographical data will also be given spanning 1580-1860, in the hope that they will not be neglected in a possible future re-edition of the Albanian Encyclopaedic Dictionary (Vol. I, II, Tirana, 2008-2009).

Bibliografi

1. Burimet

ACU – Archivio del Collegio Urbano (Roma).

AQSH – Arkivi Qendror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë (Tiranë)

ARSI – Archivio Romano della Società di Gesù (Roma)

ASPF – Archivio Storico de Propaganda Fide (Roma)

ASSC – Archivio Storico della Sacra Casa (Loreto)

BARDHI, Frang [= <Franciscus Blanc(h)us>]

1635 shih më poshtë DEMIRAJ 2008.

1636 Georgius Castriotus, Epiensis vulgò Scanderbegh, Epiotarum princeps fortissimus, ac iniuctissimus Suis, & Patriae restitutus. Per Franciscum Blancum. De Alumnis, Collegij de Propaganda Fide, iEpiscopum Sappatensem & Sardanensem, necnon Pulatensium, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem. – Venetiis. Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI

BOGDANI, Pjetër: shih më poshtë OMARI, Anila.

BARTL, Peter (bot.)

1979: Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert, Bd. II, në radhøjën „Albanische Forschungen“ Nr. 20, Wiesbaden.

2007: Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien I: Diözese Alessio. Herausgegeben und bearbeitet von Peter Bartl, në radhøjën: “Albanische Forshungen” 26/1. Wiesbaden.

2014: Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien III: Diözese Sappa. Herausgegeben und bearbeitet von Peter Bartl; në radhøjën: “Albanische Forshungen” 26/1. Wiesbaden.

EUBEL, Conrad (~ Ritzler, Remigium et Sefrin, Pirminum) 1958

1958: Hierarchia Catholica Medii et recentioris aevi, volumen VI, 1730-1799. Patavii.

FARLATI, Daniele (& COLETI, Jacopo)

1817: Illyricum sacrum, t. VII. Venetiis.

1819: Illyricum sacrum, t. VIII. Venetiis.

MARLEKAJ, Àt Jak (Luigi)

2008²: Shih më poshtë.

MARQUET, Odette (bot.)

1997 Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit. Shkodër.

NAPPI, G.: Annali del Seminario romano II, pp. 500 (?) Ms. u Archivio dell’ Università Pontificia Gregoriana, Roma (Sign. 2800-2801).

THEINER, Augustin

1875: Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam (sacram) illustrantia maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis deprompta, collecta ac serie chronologiia disposita / II, Romae.

ZMAJEVIĆ, Vincenz

1702: Relazione dello stato d'Albania e Servia visitate da Vincenzo Zmajevich Archivescouo d'Antivari. nell Anno MDCCII in III. (shih më lart Bartl, Peter 1979, 1 – 186)

ZAMPUTI, Injac (bot.)

1963: Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII, vëll. I (1610-1634), Tiranë 1963

2. Literaturë shkencore

AHMETI, Musa

2003: Gjuha shqipe pasurohet me dokumente të reja të panjohura deri tash, në: "Ekskluzive" nr. 37 [2003] 90-91.

ANSELM, Sergio

1988: Prefazione: Slavi e albanesi nell'Italia centro-orientale, në: "Italia felix. Migrazioni slave e albanesi in Occidente Romagna, Marche, Abruzzi. Secoli XIV-XVI (a cura di Sergio Anselmi). Quaderni di "Proposte e ricerche", nr. 3. Ancona, f. 11-32.

BARTL, Peter - Camaj Martin

1967: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689, në: "Zeitschrift für Balkanologie" nr. 5, f. 23-33.

CAMAJ Martin: shih më lart BARTL, Peter.

CORDIGNANO, Fulvio

1934 Geografia ecclesiastica dell'Albania: dagli ultimi decenni del secolo XVI^e alla metà del secolo XVII^e, Roma.

DEMIRAJ, Bardhyl

2006: Gjon P. Nikollë Kazazi dhe 'Doktrina' e tij. Prishtinë.

2008: (bot) Dictionarium latino – epiroticum. Una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis. Per R. D. Franciscum Blanchum Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. Romæ, Typis Sac. Congr. de Propag. Fide. 1635 (Botim kritik – përgatiti Bardhyl Demiraj). Shkodër.

2011 Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut, në: "Hylli i Dritës" 1, f. 79-96.

2012: (bot) Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706). Botim kritik, Botime françeskane, Shkodër 2012, 504 S.

2013: Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit. Shkodër 2013

2014a: Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë. Tiranë.

- 2014b: Mallkimet që lëshon ipeshkvi të Enjten e Madhe (1744 ?), në: "Hylli i Dritës" 3-4, f. 140-163.
- 2015: Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros (1663 - 1746), në : "Hylli i Dritës" nr. 3-4, f. 425-446. Shkodër.
- 2016: Damnatio memoriae vs. laudatio funebris – dy shfaqje të 'tranzicionit' intelektual në Enciklopedinë Shqiptare, në: "Milosao" – Supplement i "Gazeta shqiptare" nr. 239 (26.06.2016), f. 1-5; nr. 240 (03.07.2016), f. 2-5.
- FESH Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2008/9² (botimi i parë: Tiranë 1985).
- GRIMALDI, FLORIANO
2006: La Santa Casa di Loreto e le sue istituzioni / 1-3 Foligno (Perugia)
- ISMAJLI, Rexhep (bot.)
2006: Pjetër Budi. Poezi, Prishtinë 2006.
- JEZERNIK, Maximiljan
1971: Il Collegio Urbano, në: "Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum", Cap III, Vol. I/1 1622 - 1700, f. 465-482. Rom – Freiburg – Wien.
- JURIĆ, Josip
1982: Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, pjesa I, në: "Vrela i prinosi" nr. 13, f. 61-105.
- JURIĆ, Josip & Korade, Mijo
1983: Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, pjesa II, në: "Vrela i prinosi" nr. 14, f. 155-203.
- KOVAČEC, August
2002: Arbanasi-Albanisch, në: Wieser Enzyklopedie des europäischen Ostens; Bd. X: Lexikon der Sprachen des europäischen Ostens, Klagenfurt, f. 67-71.
- KOVAČIĆ, Slavko
2003: Il collegio illirico preso il santuario della santa casa di Loreto 1580-1798, në: "Atti del Convegno Pellegrini e Pellegrinaggi a Loreto nei secoli XV-XVIII", Loreto 8-10 novembre 2001, f. 217-249.
- MARLEKAI, Àt Jak (Luigi)
1989: Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo: con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti. Liantonio, 1989.
2008²: (bot II) Pjetër Bogdani e Shqipnia e kohës së tij: me riprodhim fotografik të 132 dokumentave Shkodër (përkthye, pajisë me shënime të veçanta dhe redaktue nga Willy Kamsi). Shkodër.
- MONTALTO, Lina
1939: Il Clementino. Roma.

MORONI, Marco

2001a: I collegi illirici delle Marche e la penisola Balcanica in età moderna, në: "Adriatico – un mare di storia, arte, cultura; Atti del Convegno 20-22 maggio 1999 Ancona", vol. I (a cura di B. Cleri), Ripatransone, f. 183-202.

2001b: Le Marche e la penisola balcanica tra economia e cultura, në: "Munus amicitiae" (a cura G. Paci, M. L. Polichetti e M. Sensi), Loreto, f. 207-210.

2003: Rapporti culturali e forme devozionali tra le due sponde dell'Adriatico in età moderna, në: "Pellegrini verso Loreto. Atti del Convegno Pellegrini e Pellegrinaggi a Loreto nei secoli XV-XVIII", Loreto 8-10 novembre 2001. Ancona 2003, 182-216.

2010: Il Collegio illirico e l'Albania, në: Marco Moroni: Tra le due sponde dell'Adriatico. Rapporti economici, culturali e devotionali in età moderna, Napoli – Roma 2010, 159-195.

NDRECA, Ardian

2008 Nji tubëz lutjesh shqip e vitit 1776, në: "Hylli i Dritës" 4, f. 161vv.

OMARI, Anila

2005 (bot.) Pjetër Bogdani: Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve). Botim kritik. Përgatitur nga Anila Omari, Tiranë.

PALTRINIERI, Ottavio M.

1795: Elogio del Pontificio e nobile Collegio Clementino di Roma. Roma.

RROTA, Justin

1941: Pjetër Bogdani – Kryevepra (1685); në: "Shkrimtarët shqiptarë" Pjesa I. (1462-1878). Për klasën e tretë e të katërt të kursit të naltë. Tiranë 1941, f. 46-65.

SANTARELLI, Giuseppe

2000: Schiavoni o albanesi e il Santuario di Loreto nei Secoli XV-XVI, në: "Adritico. Un mare di storia, arte, cultura" (A cura di Bonita Cleri). Atti del Convegno - 20-22 maggio 1999. Ancona., f. 153-180.

Zefi, Frok

2000: Arqipeshkvniija Shkup-Prizren në shekullin XVIII-të, Osijek 2000.